




FED INVEST
Finalja e Elevator
Lab, Aba Online
fituese e çmimit
të madh

Faqe 6



Ndue Zaja nga Gjegjani
'refuzon' qytetin për
vreshtarinë: E kam
pasion, por punoj dhe
për të jetuar. Sa më
shumë të rinj të kthehen
te prindërit ...

Faqe 6



I ngrohti po dëmton
bujqësinë - Ekspertët:
Problemet më të
mëdha të drurët
frutorë dhe gruri

Faqe 5



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit janar 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 453
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

MBZHR: BILANCI I PUNËS PËR 2022-SHIN DHE OBJEKTIVAT PËR 2023-SHIN

MINISTRJA KRIFCA: BUJQËSIA PERFORMOI POZITIVISHT NË NJË VIT SFIDASH. EKSPORTET BUJQËSORE MBI GJYSMË MILIARDI LEKË, RRITJE ME 15.6% NË SASI DHE 18.1% NË VLERË. SHQIPËRIA NDËR VENDET E PARA PËR PËRTHITHJEN E FONDEVE NGA BE-JA, NDIKIM EDHE TEK RRITJA E EKSPORTEVE

Disa nga prioritetet e Ministrisë së Bujqësisë për 2023-shin: Investimet e reja në ferma blegtorale, turizëm rural, mekanikë bujqësore, linja përpunimi, magazina dhe pika grumbullimi, kantina, serra e panele diellore. Agroturizmi prioritet i politikave mbështetëse, potenciale ende të pashfrytëzuara Skemat e Mbështetjes në Bujqësi, nxitje fermerëve për diversifikimin e investimeve 149.5 milionë lekë financim për flotën e peshkimit, vijon mbështetja me skemën e naftës për anijet e peshkimit

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Turizmi i qëndrueshëm nuk është i mirë vetëm për mjedisin: është i mirë edhe për arkën e shtetit

Nga: Clara García Parra, Andi Stefanllari, Mirtjon Mita



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



Ministrja Krifca me drejtorin e FAO-s Dongyu: Prezenca botërore në bujqësinë shqiptare, për politikën e duhur të eksporteve dhe rritjen e kontributit të FAO-s në Shqipëri



Faqe 2

OPINION

Vaji i politikës që nuk po ndez!

Nga Ermal Peçi



Faqe 5

FINANCIM

IPARD III, 146 milionë euro për fermerët, peshkatarët dhe agropërpunuesit



Faqe 4

PORTAL PUNËSIMI

Portali duapune.com është platforma kryesore që bën të mundur bashkimin online midis punëdhënësve dhe punëkërkuësve

Faqe 2

KËNDI I EKSPERTIT

- Domosdoshmëria e përditësimit të kategorive të tokës në njësitë administrative Fq.11
- Teknikat e krasitjes dimërore të hardhisë Fq.11
- Këshilla për fermerët që mbarështojnë bagëti të imta Fq.12
- Domatet më të shijshme në Botë - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

RISI ALBANIA

KRIFCA - DONGYU

Turizmi i qëndrueshëm nuk është i mirë vetëm për mjedisin: është i mirë edhe për arkën e shtetit

Nga: Clara García Parra, Andi Stefanllari, Mirtjon Mita - 11 Janar 2023

Ndikimi që turizmi i qëndrueshëm mund të ketë në komunitetet pritëse është shpesh i vështirë për t'u matur dhe gjithmonë i vështirë për t'u komunikuar.

Vendoseni veten në vendin e një politikëbërësi në Shqipëri, një vend me 2.8 milionë banorë, dhe mendoni se cili nga këta tituj ka potencialin për të tërhequr më shumë vëmendjen e medias: "10 milionë turistë që priten vitin e ardhshëm" ose "Iniciativat e turizmit të qëndrueshëm përmirësojnë jetesën e Komuniteteve Rurale."

Ndërsa shpresojmë se do të zgjidhni opsionin e dytë, përgjigja më e mundshme është ajo e para.

Shqipëria nuk është e vetme. Oportunitizmi politik i kombinuar me mungesën

e Zvicrës për promovimin e destinacioneve me projektin. Duke vizatuar një piramidë në një copë letër, një nga konsulentët e tyre shpjegoi se "në Zvicër, aktorët e sektorit publik dhe privat në nivele të ndryshme koordinohen për promovimin e destinacionit, duke përfshirë fshatrat, rajonet dhe lojtarët kombëtarë". Kjo rezultoi në fushata të fuqishme që përcjellin mesazhe bindëse dhe përkthehen në rritje të numrit të vizitorëve.

Ky nivel koordinimi prirret të mungojë në destinacionet në zhvillim. Përcaktimi i grupeve për promovimin e produkteve të qëndrueshme, krijimi i propozimeve për vlera dhe artikullimi i mesazheve tërheqëse përmes kanaleve të ndryshme kërkon dialog publik-privat,

rreth kësaj kauze, RisiAlbania i mbështeti në krijimin e një organizate ku bashkëtë dhe sektori privat marrin pjesë, për të menaxhuar nevojat që lidhen me turizmin.

Që nga fillimi i saj në 2019, shoqata ka arritur në mbi 80 anëtarë. Përveç shërbimeve të saj kryesore të zhvillimit të produktit, promovimit të destinacionit dhe marketingut, ajo ka nisur një revolucion të heshitur në rajon duke promovuar formalizimin e biznesit.

Çfarë është formalizimi?

Projektet e zhvillimit të turizmit shpesh shohin rritjen ekonomike, ruajtjen ose krijimin e vendeve të punës si objektivat e tyre parësorë. Megjithatë, një aspekt i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit prirret të anashkalohet: efekti i tij i mundshëm në formalizimin e biznesit.

Bizneset që nuk janë plotësisht në përputhje me taksat vendore, punësimin, licencat dhe rregullorët e përgjithshme të biznesit janë të zakonshme në Shqipëri, ku 57% e fuqisë punëtore shqiptare ekziston në një zonë gri. Megjithatë këto biznese ofrojnë mundësi për të fituar jetesën, puna në ekonominë informale shpesh shoqërohet me të ardhura të ulëta, varfëri dhe cënueshmëri. Informaliteti është më i zakonshmi në mjediset rurale.

Një rrugëtim drejt formalizimit në Shqipërinë rurale

Një nga burimet kryesore të të ardhurave të Shoqatës Visit Gjirokastër janë tarifatat e anëtarësimit. Në diskutimet e hershme rreth kërkesave të pranimit, anëtarët themelues vendosën që vetëm bizneset e formalizuara do të mund të bashkoheshin me shoqatën. Ndërsa kjo gjë fillimisht do të nënkuptonte anëtarësim më të ulët, drejtuesit e shoqatës prisnin që kjo të ndihmonte gjithashtu në adresimin e

(Vijon në faqen 4)

Ministrja Krifca me drejtorin e FAO-s Dongyu: Prezenca botërore në bujqësinë shqiptare, për politikën e duhur të eksporteve dhe rritjen e kontributit të FAO-s në Shqipëri

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca priti drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, Qu Dongyu.

Ajo u shpreh e kënaqur që një ndër personalitetet ndërqeveritare më të rëndësishëm të bujqësisë globalisht, pranoi ftësen duke kthyer në një kohë të shpejtë vizitën që ministrja Krifca zhvilloi në Romë, duke e mbajtur premtimin për të vizituar Shqipërinë.

Arsyeja e ftësës sipas saj, kishte edhe synimin për të treguar se Shqipëria, ka gjithnjë e më shumë ambicje të hapet me botën dhe të krijojë ura ndërveprimi për mundësi të reja zhvillimi të sektorit që shkojnë në linjë me objektivin për 1 miliard dollare eksporte bujqesore në vitin 2030.

"Vizita e Dongyu është tregues i rëndësisë që ka bashkëpunimi me FAO, i cili ka qenë thelbësor për zhvillimin e bujqësisë shqiptare prej një kohe shumë të gjatë edhe atëherë kur bashkëpunimet e Shqipërisë me organizatat ndërkombëtare numëroheshin me gishtat e njërës dorë", tha Ministrja Krifca.

Sipas ministres, ky komunikim i vazhdueshëm tregon edhe për rëndësinë në rritje të Shqipërisë në aplikimin e politikave të bujqësisë dhe sistemeve ushqimore të qëndrueshme, dhe në ndjekjen e praktikave të mira ndërkombëtare edhe nën udhëheqjen e ekspertizës së vyer të Organizatës për Ushqim dhe Bujqësi.

"Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit i kërkoja drejtorit të përgjithshëm që të mundësohet rritja e numrit të ekspertëve të FAO që vijnë nga Shqipëria apo të studentëve të sapo diplomuar të UBT të cilët mund të jenë përfitues të burave të praktikave profesionale të ofruara nga FAO", u shpreh ajo.

Ministrja Krifca theksoi se së bashku me drejtorin e përgjithshëm ranë dakord se vizioni ynë i veprimit është i përbashkët i lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm nëpërmjet të cilave

kërkohej rritja e sigurisë ushqimore dhe mirë ushqyerjes për të promovuar bujqësi e peshkim të qëndrueshëm, rritja e barazisë gjinore në sekto-

në cilësi nëpërmjet hartimit të bashkëpunimit me FAO të një plani 10-vjeçar rreth sigurisë ushqimore dhe zgjerimit të aksesit të popullsisë



rin e bujqësisë, mbrojtja, dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore me vëmendje të veçantë për të ndaluar dhe përmbysur degradimin e tokës dhe të biodiversitetit, për të forcuar strukturat e bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm në shkëmbimin e njohurive, ekspertizës, inovacioneve etj.

"Bashkëpunimi ynë me FAO në vitet e fundit ka prekur shumë prej këtyre temave si për shembull fuqizimi i rolit të gruas në zonat rurale, mbështetjes në hartimin dhe fuqizimin e statistikave bujqësore dhe censusit të bujqësisë, fuqizimin e zinxhirit të vlerës të blegtorisë, hartimin e planit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve të mbrojtjes së bimëve etj", theksoi Ministrja Krifca.

Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit që MBZHR miratoi këtë vit, është ndërtuar në bazë të prioritetëve të Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, të cilat shërbejnë edhe gurë kilometrikë të strategjisë së zhvillimit të vendit, dhe bashkëpunimit tonë të përbashkët.

Ministrja Krifca sqaroi se me drejtorin e FAO-s u ra dakord për objektivat e bashkëpunimit në vitet në vijim të cilat ruajnë tre drejtime kryesore:

Rritja e sigurisë ushqimore si në nivelin sasiar ashtu edhe

në ushqim të bollshëm e të sigurt.

"Së bashku me FAO do të aplikojmë në blegtorinë shqiptare plan të rëndësishëm të masave për përmirësimin gjenetik të gjedhit nëpërmjet aplikimit të një skeme kombëtare të materialit gjenetik riprodhues të sigurtë si edhe krijimin e fermave për kafshë të sigurta riprodhuese për bagëtinë e imët", vuri në dukje ministrja, duke shtuar se me kjo vizitë ka për qëllim të rrisë akoma më shumë nivelin e bashkëpunimit dhe partneritetit dhe të krijojë mundësi për programe të reja zhvillimi strategjik për arritjen e objektivave për një bujqësi të qëndrueshme, që prodhon të ardhura për fermerët dhe familjet e tyre.

Nga ana e tij, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, Qu Dongyu, tha se "Shqipëria është një vend mesdhetar me shumë biodiversitet dhe mundësi prodhimi. Le të bashkëpunojmë për këtë".

"FAO është e gatshme të bashkëpunojë me ju, të ofrojë mbështetjen e duhur. Ardhmja ime këtu është një shans për më shumë prezencë të Shqipërisë në vendimarrjen ndërkombëtare të politikave të ushqimit", deklaroi drejtorin e përgjithshëm i Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, Qu Dongyu.



e të kuptuarit të përfitimeve ekonomike të turizmit të qëndrueshëm kanë bërë që shumë vende të paraqesin veten si destinacione të turizmit masiv. Si mates të suksesit ata konsiderojnë numrin e mbërritjeve, duke injoruar efektet negative që mund të ketë mbiturizmi në vetë asetet të cilët i bëjnë ata tërheqës në radhë të parë.

Këtu hyjnë projekte të tilla si RisiAlbania, të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe të zbatuara nga Helvetas dhe Partners Albania.

Turizmi i qëndrueshëm kërkon koordinim

Në 2018 dhe 2019, RisiAlbania pati një partneritet me firmën zvicerane të konsulencës turistike "Gutundgut", e cila ndau modelin

një fushë që mund ta mbështesin projektet e zhvillimit.

Çështja është, ku të fillohet: nga lart, duke synuar ndryshimin e legjislaacionit në nivel kombëtar dhe mbështetjen e rrjedhës poshtë? Apo në nivel vendor, duke mbështetur praktikën më të mira për të arritur tek vendimmarrësit qendrorë?

RisiAlbania zbuloi se ndërsa ndryshimi i rregullore në nivel kombëtar është joshës, është më e mundshme të fillohet në nivel lokal, ku ndryshimet ndodhin më shpejt, duke lejuar gjenerimin e provave që më pas mund të shkallëzohen përmes avokimit. Kështu lindi Shoqata "Visit Gjirokastër". Projekti mblodhi bizneset nga rajoni për të identifikuar një nevojë urgjente: promovimin e rajonit si një destinacion turistik. Pasi ata u mblodhën

Portali duapune.com është platforma kryesore që bën të mundur bashkimin online midis punëdhënësve dhe punëkërkuësve


punësimin dhe edukimin.

RisiAlbania ka mbështetur portalin e punësimit duke u fokusuar në zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm biznesi për t'i shërbyer në vijimësi punëkërkuësve dhe punëmarrësve me shërbime punësimi të përshtatshme, që i ndihmojnë

ata për të takuar më lehtësisht njëri-tjetrin në tregun e punës.

Eljana Mete, menaxhere e duapune.com na tregon:

Duapune.com numëron 134 mijë të regjistruar dhe 9236 kompani. Ata marrin pjesë aktivisht edhe në rrjetet ndërkombëtare duke bërë



në këtë mënyrë të mundur përditësimin e informacioneve që lidhen me karrierën, punësimin dhe edukimin. Një ndër shërbimet kryesore është analizimi i të dhënave dhe interpretimi i tyre, i cili realizohet përmes indeksit të përshtatshëm. Vizioni ynë për të ardhmen

është që të vazhdojnë të jenë platforma kryesore që flitet për punë dhe për karrierë. RisiAlbania ka mbështetur portalin e punësimit duke u fokusuar në zhvillimin e një modeli të qëndrueshëm biznesi për t'i shërbyer në vijimësi punëkërkuësve dhe punëmarrësve me shërbime punësimi të përshtatshme, që i ndihmojnë ata për të takuar më lehtësisht njëri-tjetrin në tregun e punës.

BUJQËSIA NË VITIN 2023

MBZHR BËN BILANCIN E PUNËS PËR 2022-SHIN DHE PARASHTRON OBJEKTIVAT PËR 2023-SHIN

MINISTRJA KRIFCA: BUJQËSIA PERFORMOI POZITIVISHT NË NJË VIT SFIDASH. EKSPORTET BUJQËSORE MBI GJYSMË MILIARDI LEKË, RRIJTE ME 15.6% NË SASI DHE 18.1% NË VLERË. SHQIPËRIA NDËR VENDET E PARA PËR PËRTHITHJEN E FONDEVE NGA BE-JA, NDIKIM EDHE TEK RRIJTJA E EKSPORTEVE

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, bëri analizën e punës dhe performancës së sektorit për vitin 2022 teksa u ndal në prioritetet e përcaktuara për vitin 2023, gjatë një takimi që zhvilloi në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë ku morën pjesë fermerë, peshkatarë, grumbullues, përpunues dhe përfaqësues të medias.



Ministrja Krifca tha se, 2022 ka qenë një vit nga më sfiduesit për bujqësinë që u godit menjëherë sapo kish marrë veten nga efektet e pandemisë, me një rritje të menjëhershme të kostove të prodhimit, posaçërisht çmimit të plehrave kimike dhe çmimit të naftës. Lufta në Ukrainë solli pasojë të rënda të një çrregullimi të tregjeve ndërkombëtare. Vende të fuqishme vunë në pikëpyetje sigurinë e tyre ushqimore, disa syresh mbyllën eksportet dhe kufijtë, duke cënuar seriozisht një ekulibër normal të tregjeve të lira të ndërtuara dhe funksionale prej dekadash. Agresori dhe vendi në luftë janë ndër vendet kryesore të prodhimit të plehrave kimike ndaj përballimit i kësaj situatë u bë emergjencia jonë.

"Këto sfida kemi arritur t'i përballojmë duke iu gjendur pranë fermerëve dhe aktorëve të tjerë të zinxhirit ushqimor me shqetësimet e tyre të përditshme përmes ndërhyjeve të menjëhershme që kishin për qëllim: Mbështetjen e fermerëve për të përballuar kostot e prodhimit duke ofruar buxhetin më të madh të vënë në dispozicion të mbështetjes së drejtpërdrejtë ndaj fermerëve: Ndërhyrjet përmes marrëveshjeve politike për stabilizim e furnizimit të qëndrueshëm e të pacënuar me produktet ushqimore.

"Dhe në fakt falë punës së palodhur, përkushtimit të jashtëzakonshëm të të gjithë njerëzve të punës në bujqësi, ne ia kemi dale! 2022 ka qenë bujqësia e rezistencës, forcës për të ecur përpara pavarësisht vështirësive dhe sfidave dhe ja ku jemi me një bilanc pozitiv të këtij sektori jetik për vendin", theksoi ministrja.

1. FORCA E BUJQËSISË NË EKONOMI

Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT në tremujorin e tretë, kemi një kontribut pozitiv të bujqësisë në Prodhimin e Brendshëm Bruto me 0.05 pikë përqindje, ndërkohë që rritja e sektorit është 0.22%.

Punësimi është një tjetër element që dua të përmend ku kemi pasur rritje të punësimit në bujqësi gjatë tremujorit të tretë me 6.5% në punësimin në sektor.

Një tjetër indikator domethënës është rritja e pagës mesatare në sektor – një rritje me 15.7% në tremujorin e tretë të vitit 2022, që është rritja më e shpejtë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë.

Sektori është më i formalizuar se dje. Tanimë janë rreth 85 mijë fermerë të pajisur me NIPT, të cilët janë të orientuar drejt aktivitetit tregtar dhe përfshirjes së plotë në zinxhirat e tregimit të produkteve bujqësore. Janë 36% më shumë fermerët me NIPT se në fund të vitit 2021.

2. PRODHIMI

Të dhënat paraprake të parashikimit të dytë të prodhimit bujqësor dhe blegtoral të 2022 flasin për një stabilitet të prodhimit dhe madje një rritje të lehtë.

Krahasuar me të dhënat faktike të vitit 2021, kemi ecure pozitive të prodhimit me një rritje të parashikuar për kulturat si vijon: grurë (4%), elb (22.4%), foragjere (2%), luleshtyrde (10%), pemë frutore (5%), ullinj (39%), agrume (9%), rush (3%), mjaltë (6%).

Pra kemi ruajtur stabilitetin e perimeve, drithërat në total kanë një ecure më mirë se viti i kaluar dhe frutikultura më mirë se viti i kaluar.

Këto rezultate janë të mira nëse, konsiderojmë edhe kushtet e vështira klimatike të këtij viti me një verë afrikane që ndikoi negativisht në kulturat e dyta në serra.

Mishi dhe qumështi ka një rënie me 5%, me impote të produkteve blegtorale konstante dhe fenomene të rënies së importit për qumështin.

Diskutimi për blegtorinë është pa dyshim kompleks edhe për shkak të strukturës së blegtorisë të dominuar nga fermat e vogla, duke mbetur një sfidë.

Probleme strukturore të madhësisë së tufës, të cilat ne përpiqemi t'i orientojmë përmes politikave që rrisin qëndrueshmërinë ekonomike të tyre dhe produktivitetin.

Fenomeni është tërësor, veçanërisht në Evropë, ku gjatë dy dekadave të fundit, ka pasur një rënie të numrit të bagëtive në dy dekadat e fundit me 9%.

Blegtoria mbetet angazhim për ne gjatë këtij viti.

Gjithsesi sikundër përmenda më herët, bazuar në të dhënat paraprake të parashikimit të dytë të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, mbetemi në nivele të stabilizuara, me një rritje të lehtë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e ka të mbështetur strategjinë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit në disa objektiva kryesorë: Mbajtja e qëndrueshmërisë së prodhimit, Eksportet, siguria ushqimore, zhvillimi rural, peshkimi dhe digitalizimi.

3. EKSPORTET

Një objektiv i arritur dhe i tejkaluar ai që i vendosëm vetes për eksportet gjatë 2022.

Eksportet paraprake të produkteve bujqësore 2022 na tregojnë se eksportet shqiptare kanë arritur 55.1 miliardë lekë

- Rritje +18% në vlerë në krahasim me 2021
- Rritje +16% në sasi në krahasim me 2021

raporti eksport/Import është përmirësuar nga 1 me 3 në 1:2.85 duke u përmirësuar me 0.16 pikë

Struktura e eksporteve shqiptare ka pësuar një përmirësim cilësor, si dëshmi e vlerës së shtuar, që tanimë ka produkti i përpunuar. Rritja e eksporteve në vlerë ka si burim kryesor edhe çmimin e rritur të produktit të papërpunuar në eksport, për ato produkte me cilësi konkurruese dhe avantazhe krahasuese.


Kjo vihet re lehtësisht nëse krahasojmë përbërësit kryesorë të strukturës së eksporteve.

Sipas sasisë: Bujqësi 66%; Agroindustri 31.3%; Peshkim (peshk i freskët) 2.3%; Blegtori 0.5%.

Sipas vlerës: Bujqësi 42.7%; Agroindustri 42.2%; Peshkim (peshk i freskët) 14.1%; Blegtori 0.9%.

Në produktet, që po marrin vlerë të shtuar janë disa kategori model, si zarzavatet e përpunuara me domate të përgatitura apo të ruajtura, kastarveca të konservuara, specat dhe perime të tjera, fruta, arra, lëkura frutas, peshku i përgatitur apo konservuar, krustacët dhe molusqet. Në rastin e zarzavateve të përpunuara, për çdo një njësi të rritur eksporti në sasi, është rritur 4 herë eksporti në vlerë.

Bujqësia si përbërës i eksporteve mban 66% të peshës në sasi, por mban edhe 42.7% të peshës në vlerë. Brenda kësaj kategorie Fruta-perimet zënë



88% të sasisë dhe vlera e tregtuar ka qenë më e lartë. Pjeptrat dhe shalqinjët, për çdo një njësi rritje të eksportit në sasi, është rritur 4 herë eksporti në vlerë. Agrumet, për çdo njësi të rritjes së eksportit në sasi, janë rritur 1.6 herë në vlerë. Kastravecat, për çdo njësi të rritjes së eksportit në sasi, rriten 1.5 herë në vlerë. E kështu me radhë.

Këtu gjeni edhe produktet kampion të eksporteve:

Sipas të dhënave paraprake, në 2022 prodhimi i pemëve frutore në vend u rrit me +4.98%, ose me 14,314 ton më shumë.

Një punë e madhe voluminoze e zinxhirit tonë prodhues e përpunues që meriton një falenderim të veçantë dhe një mirënjohje të posaçme.

Ministrja u ndal në masat për nxitjen e eksporteve bujqësore

Sipas saj, pjesa më e madhe e skemave të mbështetjes janë të orientuara drejt fuqizimit të prodhimit dhe eksportit.

"Kemi siguruar mbështetje progresive për prodhimin dhe ndërtimin e infrastrukturës që lehtëson eksportet, me investime në rritjen e sipërfaqeve të serrave, rritjen e kapaciteteve grumbulluese frigoriferike, fabrikave, linja përpunimi dhe pajisje e teknologji, Investime në kantina e thertore me standarte e teknologji të lartë.

Tregje të reja dhe zgjerimi i tregjeve ekzistuese; Në 2022 është eksportuar në 73 vende – 10 vende të reja; Prioritet absolut shërbimit të mbrojtjes së bimëve për pajisjen e certifikatave fitosanitare në kohë e pa burokraci eksportuesve. AKU prioritet absolut në pikat kufitare ka garantimin por dhe lehtësimin e eksporteve; Kemi marrë Angazhim për lehtësimin e tregtisë, akses në tregje të reja dhe reduktimin e barrierave tarifore dhe jotarifore të lidhura me sektorin", tha Krifca.

Ministrja e ndal tek zgjerimi i Bashkëpunimit Rajonal dhe Ballkani i Hapur, ku janë miratuar disa marrëveshje thelbësore për zgjerimin e eksporteve

- Marrëveshja për njohjen e certifikatave në fushën fitosanitare, të veterinarisë dhe sigurisë ushqimore
- Memorandum i Bashkëpunimit mes vendeve në rastet e përkeqësimit të krizës

REZULTATET E OB

- Volumi tregtar në bujqësi në 2022 ka një rritje +25% me të dy vendet.
- Eksportet bujqësore shqiptare me Serbinë +58.2% në vlerë dhe në sasi rritur me +13.6% Eksportet bujqësore shqiptare me Maqedoninë e Veriut +37.2% në vlerë dhe në sasi rritur me +32%
- Kemi përmirësuar raportin import eksport me këto vende. Importet bujqësore me Serbinë kanë rënë me -9% dhe me Maqedoninë e Veriut me -22%.

Lehtësimi i procedurave

• Nëse në 2021 në pikat e inspektimit kufitar kryheshin 10 hapa proceduriale e dokumentarë dhe shpenzohej nga 30 minuta deri në 7 ditë,

• Në 2022 kemi vetëdorëzim të dokumentave origjinalë dhe shpenzohet 5-10 minuta në kufi. Kështu në tërësi:

- Kemi kursyer 6600 orë në kufi
- Kemi rritur eficientë dhe përdorimit të mjeteve të transportit duke mos i mbajtur të bllokuar duke kursyer kohë e para për plotësimin e praktikave dokumentare
- Kemi parë një rritje me +73% eksporte në numër ngarkesash dhe +94% eksporte në volum ngarkesash.

Edhe me vendet e tjera të rajonit, bashkëpunimi ka qenë në rritje në bujqësi.

Kështu, me Kosovën janë hequr edhe barrierat administrative për kontrollet dhe analizat në kufi duke kursyer kohë dhe para për sipërmarrjen.

Dhe ndërkohë me të gjithë vendet e CEFTA – Marrëveshje së Tregtisë së Lirë në Evropën Juglindore, kemi realizuar një proces fillestar të Digitalizimit dhe standardizimit të hyrje-daljeve nga Pikat e Inspektimit Kufitar.

Në mes të vitit filluam zbatimin e projektit SEED+, dhe sistemit sistemit evropian CEFTA-TRACES për import-eksport për bimë dhe produkte bimore mes vendeve pjesë e CEFTA.

Shqipëria kryeson listën e vendeve në CEFTA për përdorimin e sistemit dhe kursimin e kohës së procesimit të eksportit dhe pritjes së kamionave në kufij. 86% e certifikatave fitosanitare të të gjithë projektit pilot të BE e kanë origjinën nga Shqipëria.

"Valbona Arapi është një nga vajzat ambicioze shembull të punës për rritjen e eksporteve, por edhe shembull që mbështetja jonë përmes programeve të financimit, ka shkuar në mbështetje të fuqizimit të zonave rurale dhe nxitjes së eksporteve. Ajo është përfutuese nga programi IPARD II për pikë grumbullimi, fruta perime dhe dhoma frigoriferike. Sot kompania e saj eksporton rreth 18 mijë ton, shifër kjo që tregon punën e palodhur por edhe potencialin e padiskutueshëm të bujqësisë. Ne duam që e ardhmja të jetë e mirë për bujqësinë shqiptare dhe ambicioze, ndaj vazhdimi i politikave orientuese e zhvilluese si për rritjen e prodhimit ashtu dhe për infrastrukturën mbështetëse të kapaciteteve, marketingun dhe promovimin do të jetë thelbësore për arritjen e objektivit 1 miliardë USD eksporte deri në 2030 dhe rritjen në 60 miliardë lekë në vitin e ardhshëm", deklaroi Krifca.

4. SIGURIA USHQIMORE

Është një prioritet i rëndësishëm për ministrinë ku kemi realisht një kantiër të madh edhe në përafrimin e standardeve me BE.

Dua ta nis me Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare ku kemi investuar 1.8 milionë EUR për përmirësimin e infrastrukturës dhe modernizimin e laboratorëve duke i dhënë krenari institucionit më të rëndësishëm për sigurinë ushqimore.

Është i vetmi laborator reference i cili garanton sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, ushqimeve për kafshë, mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet analizave të thelluara laboratorike.

Objektivi kryesor i vitit 2022 për ISUV ka qenë mirëmbajtja e akreditimeve dhe zgjerimi i tyre me teste të reja për fushat e Veterinarisë, Sigurisë Ushqimore, Fitosanititetit në përputhje me standardet ISO per

- Analizimin e Pesticideve në fruta-perime, Analizimin e Metaleve të



Rënda në produktet e peshkimit si dhe Analizimin e diagnozës së Influencës Aviare nëpërmjet teknikave molekulare (RT-PCR) dhe serologjike.

ISUV e ka përmbytur plotësisht objektivin me akreditimin e 1272 teste të reja dhe ka bërë një hap shumë të rëndësishëm përpara në drejtim të rritjes së eficientës duke kryer përtej analizave të kontrollit zyrtar edhe 10.147 analiza për eksportet dhe për bizneset me një reduktim prej 87% në kohë për marrjen e përgjigjes nga paraqitja e mostrës në sportetelet e ISUV.

Në dhjetor miratuar gjithashtu një VKM që shkencëtarëve dhe ekspertëve që punojnë në ISUV t'i rrisim mundësitë ekonomike dhe administrative përshirje rritjen e pagave prej 30%, në mënyrë që institucioni të vlerësohet dhe të mbajë statusin e institutit dhe ekselencës në studimet veterinarë dhe të ushqimit.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Gjatë 2022 me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit është punuar të profilizojmë me bazë risku më shumë se 21 mijë operatorë në një metodologji në përputhje me praktikën e Bashkimit Evropian. Qëllimi është që Operatorët e Biznesit Ushqimor me risk më të lartë të kontrollohen më shpesh në raport me

IPARD III, 146 milionë euro për fermerët, peshkatarët dhe agropërpunuesit

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca në përmbledhjen e aktivitetëve javore të institucionit që drejton e vuri theksin në disa ngjarje të rëndësishme.

Krifca u ndal së pari tek miratimi në qeveri dhe nisjen për shqyrtim në Parlament të marrëveshjes sektoriale për financimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, të një programi tërësisht të ri me Bashkimin Evropian, IPARD III, duke marrë dhe vendosur një angazhim financiar prej 146 milionë euro, në dispozicion të fermerëve, të peshkatarëve, të agropërpunuesve, grupeve vendore të veprimit, aktorëve të agromjedisit, bujqësisë organike, zhvillimit rural në tërësi.

“Ky program do të hapë dritaren më të madhe dhe më të rëndësishme të financimit ndonjëherë dhënë për bujqësinë, që ajo të modernizohet dhe të përafrohet me standardet e Bashkimit Evropian. Risia e programit të ri është që zgjerohet gamën e përfutjesve dhe të financimeve edhe me 5 masa të reja, që përfshijnë masën e pyjeve, masën agromjedisore, qasjen LEADER për zhvillimin e grupeve lokale të veprimit apo investimet për infrastrukturën rurale në përputhje me nevojat e bashkive”, theksoi Krifca.

Me të njëjtën frymë, tha Krifca, “këtë javë ne kemi miratuar dhe rritjen e buxhetit në Skemën Kombëtare me 200 milionë lekë të dedikuara ndaj blegtorisë, mbështetur kështu edhe 1 mijë blegtorë të tjerë nga Skema Kombëtare e Mbështetjes, duke e çuar numrin e përfutjesve në 47,000 fermerë, me një nivel historik mbështetjeje, prej 5.1 miliard lekë për vitin 2022”.

“Gjithashtu në këtë javë tejet të rëndësishme, miratuar në Komisionin e Veprimtarive

Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, ligjin e ri për verën dhe vresh-tarinë. Një ligj që është punuar gjerë me gjerë, me kujdes, i shumëpritur nga prodhuesit e rrushtit, përpunuesit, kantinat, enologët dhe këdo kupton stadin e ri të cilësisë ku gjendim aktualisht, si dhe prioritetet e të ardhmes në fushën e verëtarisë. Ligji krijon standarde të reja, formalizon, fuqizon prodhimin vendas dhe varietetet autoktone, duke i dhënë atyre vlerë, krijon gjurmueshmëri të prodhimit vendor, kushtet e zgjerimit dhe eksportit në tregje të reja, ndërkohë që përmes këtij projektiligji ne plotësojmë kërkesat e prodhuesve, por dhe kërkesën e vazhdueshme të raportit progresit nga Komisioni Evropian”, nënvizoi ajo.

Krifca u shpreh se “më erdhi mirë këtë javë të konstatoj gjithashtu se Shqipëria ka qenë në pararojë gjatë vitit 2022, në ecurinë e projektit pilot SEED+ të lehtësimit të procedurave të tregtimit të produkteve bujqësore. Është një projekt i mbështetur nga Bashkimi Evropian, në zbatim nga vendet e Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë në Vendet e Evropës Qendrore (CEFTA). Kështu, gjatë punës së Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Shqipëria është renditur e para, mes këtyre vendeve që kanë marrë pjesë duke pilotuar projektin, duke u vlerësuar si partneri më aktiv, me lëshimin e numrit më të lartë të certifikatave digjitale fitosanitare, prej fillimit të zbatimit të projektit pilot nga korriku i vitit 2022”, theksoi Krifca.

Ministrja Krifca informoi se “brenda ministrisë, me të gjithë drejtuesit e programeve buxhetorë jemi në një punë të dedikuar për mbylljen e deta-

jimit të buxhetit për vitin 2023, një buxhet i cili kemi vendosur të ketë në fokus fermerët, blegtorët, njerëzit e punës dhe ata që punojnë në zhvillimin e qendrueshëm të zonave rurale”.

Lidhur me situatën nga moti, Krifca tha se “në këto ditë të paqëndrueshme të motit, stafi ynë është në territor me të gjithë infrastrukturën kulluese, mbrojtëse, mbështetëse për të ndihmuar dhe asistuar aty ku duhet përbalimin e reshjeve”.

“Së fundmi, së bashku me Kryeministrin pata mundësinë që të vizitoj dy kontribues të rëndësishëm të bujqësisë gjatë kësaj jave, por edhe zhvillimit rural. Në Kamzë vizitua kompaninë Riviera, që përmes programit IPARD ka mundësuar ngritjen e një qendre moderne grumbuluese frigoriferike me kapacitete shumë të mëdha për grumbullimin, seleksionimin, ruajtjen dhe eksportin e fruta-perimeve. Një pol i rëndësishëm i bujqësisë moderne me një rrjet të gjerë fermerësh që grumbullojnë produktet aty. Ndërkohë në Surrel vizitua Ismetin, djalin e “Cerenit”, shefin e famshëm të kuzhinës, i cili ka investuar në një pol tjetër të agroturizmit dhe përpunimit artizanal të produkteve ushqimore të grurit, të qumështit, të frutave-perimeve, të mishit, të verës, e cila në fakt përveçse në fakt një pikë e re atraksioni agroturistik, do të jetë edhe një laborator i jashtëzakonshëm kulinarie, fantazie në një ish-repart ushtarak të braktisur, cili do t'i ofrojë vizitorëve dhe prodhuesve të Tiranës, qendrën më të re të përpunimit ushqimor kulinar të prodhimeve lokale të nivelit mjaft të lartë”.

“Të dy këta janë shembuj të vizionit tonë të zhvillimit të bujqësisë dhe të agroturizmit”, tha Krifca.

Studim: Ndonëse punojnë më shumë në bujqësi, gratë rurale përjashtohen nga e drejta pronësore

Ndonëse sipas ligjit gëzojnë të drejta të barabartë në trashëgiminë e familjes, në realitet, shumë pak vajza dhe gra përfitojnë nga e drejta e pronës.

Studimi: “Hendeku gjinor në pronësi dhe trashëgiminë e tokës në Shqipëri” ka analizuar të dhënat e marra nga intervista me 1,258 gra në 12 qarqe të Shqipërisë. Në këtë studim u përfshinë edhe të dhëna të mbledhura nga fokus-grupe me 58 gra të moshës 45-60 vjeç që jetojnë në zona rurale.

Shtypja e shtresëzuar e grave rurale

Studimi nxjerr në pah se gratë rurale kanë më pak mundësi se gratë që jetojnë në zonat urbane të shkollohen, të kenë përfaqësi në jetën politike dhe të punësohen. Nga ana tjetër, studimi tregon se gratë rurale ndonëse bëjnë një pjesë të madhe të punës mbeten sërish të varfra dhe të përjashtuara nga e drejta e pronës.

“Gratë rurale në Shqipëri përballen me tre shtresa shtypjeje: patriarkalizmi dhe autoritarizmi në qeverisje, hegjemonia mashkullore brenda komuniteteve dhe familjeve të tyre dhe varfëria”, – shkruhet në studim.

“Rezultoni se shpesh, vetëm kryefamiljari (zakonisht burrë) regjistrohet zyrtarisht në kadastrë si përfaqësues i fermës familjare”, – thuhet më tej në studim, ku gratë i referohen vetes si “shtëpiake”.

Ndonëse të gjithë anëtarët e familjes kontribuojnë në bujqësi, gratë, veçanërisht ato më

të rejt punojnë më shumë dhe janë më të marginalizuara. “Ata punojnë më shumë se burrat dhe prirjen t'u binden vendimeve të burrave, baballarëve, vëllezërve dhe madje edhe djemve të tyre”, – shkruhet në studim.

Sipas të dhënave të mbledhura, 48% e grave besojnë se duhet të sakrifikojnë të drejtat e tyre për të ruajtur “harmoninë në familje”.

Ligjet zakonore, ende “rregullatorë” të shoqërisë

Sondazhi zbulon se ligjet zakonore janë ende shumë të pranishme në zonat rurale të Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me të drejtat e tokës, rregulla të cilat janë të njohura dhe të pranura nga gratë.

“Ligjet zakonore nuk i favorizojnë gratë kur bëhet fjalë për pronësinë, trashëgiminë dhe vendimmarrjen në përgjithësi”, – citohet në studim.

Sipas të dhënave të mbledhura, më shumë se gjysma e grave të anketuara (52%) i besojnë rregullave zakonore dhe të afërmve, krahas ligjit



(46%). Më pak se gjysma e të anketuarave besojnë se ligjet shtetërore duhet të ndiqen kur merren vendime për shitjen e tokës.

Të dhënat e mbledhura nga studimi tregojnë se gratë prirjen të ndjekin udhëzimet e burrave, duke besuar se burrat e familjes do të marrin vendime të drejta në emër të familjes.

Më shumë se gjysma e grave të anketuara (57%) ia besojnë vendimet për çështjet e trashëgimisë burrave ose familjes. 27% e grave të anketuara pohojnë se nuk e kanë parë asnjëherë certifikatën e pronësisë së tokës.

Perceptimet e grave për të drejtën pronësore

Në studimin e kryer, rezultoni se një e pesta e grave mendojnë se nuk kanë të njëjta të drejta pronësi si burrat.

Gratë që janë të njohura me kuadrin ligjor tentojnë të kenë më shumë sens barazie në marrëdhëniet familjare krahas gratë rurale, të cilat janë më të njohura me rregullat zakonore. Sipas të dhënave të mbledhura nga fokus-grupet, gratë rurale shprehen se shpesh zgjedhin heqin dorë vullnetarisht nga prona e familjes, pasi nuk duan të prishin marrëdhëniet me këta të fundit.

Në raste të tjera, kur gratë martohen dhe zhvendosen, ato nuk mund ta shfrytëzojnë më tokën për prodhime bujqësore, si pasojë e largësisë gjeografike.

“Megjithatë, aty ku vlera e tokës është shumë e lartë, si në afërsi të kryeqytetit ose përgjatë bregdetit, mosmarrëveshjet brenda familjes mbi pronësinë janë më të zakonshme dhe shpesh përfshijnë gratë”, – shkruhet në studim.

(Vijon nga faqja 2)

çështjes së madhe të informimitit në sektorin e turizmit. Në të vërtetë, shumë operatorë turistikë luftuan me një model ku investuan bizneset rurale, siç ishin bujtinat, për t'i sjellë ato në standardin e pritur nga turistët dhe më pas nuk ishin në gjendje të zbritnin fiskalisht kontributet e tyre për shkak të statusit informal të bizneseve.

Pas një viti sfidues të shënuar nga një kolaps global i industrisë së udhëtimit, bizneset e vogla kanë kërkuar siguri dhe mbështetje. Visit Gjirokastra mori një rol proaktiv në ofrimin e informacionit dhe udhëzimeve të përshtatura për sipërmarrësit në rajon për masat e shëndetit dhe sigurisë, përshtatjen me ndryshimin e rregulloreve dhe udhëzimet strategjike gjatë fazës së rifillimit të turizmit. Kjo, e kombinuar me një ofertë shërbimi të mirëpërcaktuar që është ndër-

tuar kryesisht rreth zhvillimit të produktit dhe marketingut, ka sjellë anëtarësim të mbi 80

bizneseve që paguajnë.

Kryetarja e shoqatës Kristina Fidhi tha: “Në dy vite janë regjistruar 45 biznese të vogla dhe të mesme, përfshirë bizneset ekzistuese që donin të bëheshin pjesë e shoqatës dhe biznese të reja fillestare që u frymëzuan nga puna e saj”.

Mundësitë për sektorin publik

Dyzet e pesë mund të duket si një numër i vogël në skemën e madhe të gjërave, por përfaqëson një ndryshim thelbësor në mentalitet, që ka potencialin të jetë transformues.

Formalizimi i biznesit rural është një lajm i mirë për kompanitë që tashmë janë në gjendje të zbrisin fiskalisht investimet e tyre në këto biznese,

si dhe për autoritetet tatimore vendore. Bashkitë e kuptojnë se tërheqja e turistëve në një rajon ka efekte pozitive ekonomike dhe një nga mënyrat për ta arritur këtë është përmes krijimit të organizatave të menaxhimit të destinacionit (DMO), të cilat prirjen të financohen kryesisht nga taksat e shtratit. Por me norma të larta informaliteti, Shqipëria ka shumë pak shanse për të krijuar struktura solide nëse bizneset nuk formalizohen.

E rëndësishme është se bizneset formale kontribuojnë gjithashtu në shërbimet publike të ofruara nga bashkitë, si menaxhimi i mbetjeve, një zonë në të cilën Helvetas po punon edhe në Shqipëri nëpërmjet projektit “Bashki të Forta”

Një pikë kthese për turizmin

Pandemia e COVID-19 krijoi sfida të mëdha për bizneset e vogla turistike në Shqipëri,

si në çdo vend tjetër të botës. Por viti i kaluar ka sfiduar shumë ide të mëparshme, në faktin se sa të dobishme ose të dëmshme ishin për zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të turizmit dhe në mënyrë thelbësore u ka dhënë operatorëve turistikë pak kohë për të rimenduar strategjitë e tyre dhe për të mbledhur mësimet e nxjerra.

Në Gjirokastër, pandemia ka rritur interesin e bizneseve të rajonit për të qenë pjesë e shoqatës. Kur kohët janë të pasigurta, bizneset i drejtohen partnerëve që mund t'u ofrojnë shërbime dhe siguri. Shoqata e përballoi këtë sfidë duke u fokusuar me shpejtësi për të tërhequr turistët rajonalë dhe për të mbështetur biznesin rural për të përshtatur ofertat e tyre, duke vazhduar ndërtimin e një pranije të fortë në rajon

që do të nxisë më tej formalizimin e biznesit. Viti 2022 ishte një pikë kthese për turizmin në qarkun e Gjirokastrës. Shoqata punoi ngushtë me shtatë bashkitë dhe prefekturën e qarkut për krijimin e një komiteti koordinues publiko-privat për sektorin e turizmit. Kjo ishte hera e parë që një komitet i këtij lloji ngrihej në një rajon shqiptar me pjesëmarrjen e aktorëve publikë dhe privatë dhe me udhëheqjen e shoqatës. Aktorët po koordinojnë strategjinë dhe aktivitetet e promovimit rajonal. Krahas rezultateve të deritanishme të formalizimit, ky bashkëpunim do të jetë i dobishëm për qëndrueshmërinë e proceseve të formalizimit në planin afatgjatë.

Viti 2022 ishte një pikë kthese edhe për turizmin në Shqipëri. Organizata Botërore

e Turizmit e Kombeve të Bashkuara (UNWTO) e renditi Shqipërinë vendin e dytë me performancën më të lartë në Barometrin Botëror të Turizmit për vitin 2022, me një rritje prej 19% të vizitorëve ndërkombëtarë krahasuar me nivelet para pandemisë nga viti 2019. Megjithatë, kjo sjell rrezikun e mbiturizmit. Aktorët kombëtarë dhe lokalë, me mbështetjen e projekteve udhëheqëse si RisiAlbania, po formulojnë drejtimin e ri të industrisë drejt standardeve të turizmit të qëndrueshëm. Në nëntor 2022, Ministria e Turizmit, palët e interesuara të sektorit privat dhe RisiAlbania organizuan një konferencë mbi standardet e turizmit të qëndrueshëm me pjesëmarrjen e folësve ndërkombëtarë, përfshirë CEO të Këshillit Global të Turizmit të Qëndrueshëm (GSTC).

Duke përqafuar këtë vizion për rajonin, Shoqata

(Vijon në faqen 3)

OPINION

Vaji i politikës që nuk po ndez!

Nga Ermal Peçi

Në prag festash kisha vendosur të qëndroja larg sherrnave politike dhe shkrimeve me kontekst politik, por mesa duket qenka e pamundur. Një deklaratë e Frida Krifcës për mbiprodhim dhe mungesë orientimi të tregut ka ngritur një stuhi mediatike-civile-politike,

tuar jetën ullirit dhe këtij profesioni. Stuhi në një gotë boshe mund të quhet kur profesion-

fakt që nuk i shërben fermerit dhe njeriut të punës.

Por le të analizojmë në fakt se çfarë tha Frida Krifca si Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural!

"Ne kemi një prodhimtari të lartë siç ju përmendni të vajit të ullirit, por dhe të prodhimit të ullirit. Rreth 20% e tij tregtohet aktualisht në vendin tonë si ullinj dhe 80% si vaj ulliri. Kemi pasur ndër vite një problematikë sistematike do të thoja të sektorit të bujqësisë me një mbiprodhim, me një mbi mbjellje të rrënjëve të ullinjve. Janë rreth 10 milionë rrënjë në të gjithë vendin, të cilët herë pas here janë mbjellë pa një strategji dhe pa një planifikim të qartë, të cilat sjellin më pas mbiprodhim në momente të caktuara, e cila nuk

është shoqëruar njëkohësisht me strukturat e përpunimit, me fabrikat e përpunimit, pavarësisht se kemi rreth 250 të tilla aktualisht në vend, për të shoqëruar një përpunim të saktë, të rregulluar, me cilësi të lartë, me procese certifikimi ndër vite kështu që herë pas here gjendemi përballë vështirësive të tilla. Jemi duke punuar vazhdimisht edhe me kuadër ligjor edhe kuadër rregullativ, por edhe në kontaktet që unë kam pasur së fundmi dhe me ministrin italian dhe francez, kam shprehur gatishmërinë për të fuqizuar më tej këtë sektor edhe nëpërmjet teknologjive italiane këtu".

Këto fjalë janë një diagnozë e një sektori, i cili vuan prej vitesh nga mungesa e orientimit, bashkëpunimit dhe rritjes së standardeve dhe cilësisë për t'u

bërë i konkurrueshëm në tregun vendas, por edhe ndërkombëtar. E vërteta dhemb por duhet parë në sy, sepse në qoftë se ne po kërkojmë Bashkimin Evropian, jo vetëm duhet të ofrojmë cilësi dhe standarde, të cilat sigurisht arrihen vetëm nëpërmjet një strategjie, e cila të mundëson të zhvillohesh dhe të rritesh. Këto fjalë nuk janë as sulm politik, por janë fjalë që kërkojnë të orientojnë fermerin, nga gabimet e mëparshme. Duhet të zgjohemi nga një realitet komunist që qendra e botës jemi ne, duhet të zgjohemi për të kuptuar që kur flasim për verën, vajin, blegtorinë, bujqësinë nuk jemi të vetmit në rajon dhe as në Evropë, por ka shumë vende të cilat ne as nuk i konkurrojmë dot si Italia, Franca dhe Span-

ja sepse vendet e zhvilluara funksionojnë me avantazhe krahasuese. Bashkimi Evropian funksion me teorinë e Rikardos, ku secili vend fuqizon pikat e forta dhe nëpërmjet këtij modeli zhduk pikat e dobëta dhe kështu duhet të funksionojë çdo sektor përfshirë bujqësinë. Këto fjalë janë të vërteta për të kuptuar që fermerët duhet të orientohen e të bashkohen si modeli i fermerëve të Xarrës sepse deklaratat politike janë kalimtare, por fermerët janë aty dhe problemet e tyre i shoqërojnë çdo ditë.

Në vendet si Shqipëria që kanë një të kaluar post komuniste dhe që kanë një tranzicion politik të tejzgjatur, i cili nuk po mbaron kurrë mund të gjejsh gjithçka përveç profesionistëve. E për sa kohë ky vend nuk do të ketë profesionistë do të ketë grupe politike mediatike që sa herë të duan për interesa të tyre do të prodhojnë stuhi në gotë boshe.



një stuhi e cila i ka të gjitha elementët e përfshirë përveç atyre që janë kryesorët, ekspertët njerëzit që i kanë kush-

istët dhe njerëzit e fushës nuk shprehen dhe më pas amplifikohet zhurma për interesa politike dhe mediatike. Zhurmë në

Aplikohet bujqësia inteligjente - Korçë, fermerët kontrollojnë prodhimin përmes teknologjisë

Ky është një prej stacioneve që jep e merr të dhëna sateli-

mbjella me mollë në gati 60 varitete të ndryshme në fshatin

mbulon një rreze prej afro 5 kilometrash.



tore. Të dhëna të cilat pasi janë përpunuar nga specialistë të fushës u kalohen fermerëve të cilëve iu shërbejnë për të realizuar trajtimet e ndryshme në sektorin bujqësor.

Ylver Bylykbashi është një nga fermerët e parë në Korçë që ka nisur të aplikojë teknologjinë me qëllim rritjen e rendimentit të prodhimit. Ai ka më shumë se 20 hektarë të

Shamoll.

Prej dy vitesh Bylykbashi ka vendosur në parcelat e tij stacione metrologjike të cilat përmes aplikacioneve në celular i përcjellin të dhëna në kohë reale mbi temperaturën, lagështinë por dhe për rreziqet që mund t'i kanosen gjatë fazës së prodhimit të mollës. Një pajisje e tillë kushton nga 3 deri në 4 milion lekë të vjetra dhe

Ylver Bylykbashi, fermer
Nëpërmjet aplikacioneve satelitore ne bëjmë të mundur që të marrim të dhëna për sëmudjet, demtiesit, kohën kur paraqesin rrezikshmëri. Dhe nëpërmjet këtyre të dhënave ne ndërhyjmë për të marrë masa. Por dhe ushqimin

Kjo risi teknologjike, sipas tij, redukton ndjeshëm koston e prodhimit krahasuar me bujqësinë tradicionale.

Në qarkun e Korçës ka dhe stacione të tjera për të njëjtin qëllim por ndryshe nga Bylykbashi fermerët nuk i kanë në funksion për shkak të mospagesës për shërbimin që ofrojnë.

Me lëshimin në hapësirë të dy satelitëve shqiptarë, fermerët shpresojnë që koston e bujqësisë inteligjente të reduktohen akoma më shumë pasi nuk do ta marrin më informacionin nga satelitët e huaj.

Turizmi i qëndrueshëm nuk është i mirë vetëm për mjedisin: është i mirë edhe për arkën e shtetit

(Vijon nga faqja 4)

Rreth Autorëve

Clara García Parra është një konsulente e pavarur e specializuar në sistemet gjithëpërfshirëse të tregut, zhvillimin e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës. Ajo është e apasionuar pas ekonomisë qarkulluese dhe sipërmarrjes rigjeneruese dhe ka mbështetur biznese në sektorë të tillë si turizmi, agrobiznesi, TIK dhe financat për të pilotuar modele inovative biznesi

Visit Gjirokastra organizoi gjithashtu një seminar mbi standardet GSTC për bizneset dhe aktorët e turizmit të rajonit. Pesë vetë nga stafi menaxherial dhe anëtarët e shoqatës, kanë ndjekur trajnimin e Këshillit Global të Turizmit të Qëndrueshëm (GSTC) për menaxhimin e destinacionit dhe hapi tjetër do të jetë mbështetja e shoqatës për të shpërndarë këto standarde dhe për të lehtësuar miratimin e tyre në rajon - duke i çuar këto ide në nivel kombëtar.

Andi Stefanllari, Ph. D., është Drejtuesi i Komponentit të Zhvillimit të Sektorit Privat për projektin RisiAlbania dhe

një ekspert i lartë privat i zhvillimit të sistemeve të tregut, me më shumë se 15 vjet përvojë në hartimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve për të rritur konkurrencën në sektorët e ekonomisë private, përfshirë TIK-un, agrobiznes dhe turizmin.

Mirtjon Mita është Menaxher i Ndërhyrjes për Turizmin në RisiAlbania dhe ka punuar me projektin që nga viti 2017. Ai ka përvojë të gjerë në bashkëpunim me biznese private si konsulent dhe në pozicione drejtuese në disa nga sipërmarrjet më të rëndësishme në Shqipëri.

I ngrohti po dëmton bujqësinë - Ekspertët: Problemet më të mëdha të drurët frutorë dhe gruri

Temperaturat më të larta se zakonisht për stinën e dimrit po ndikojnë kulturat bujqësore.

Prej motit të ngrohtë, pemët e frutave kanë filluar të çelin lule më herët, ndërsa gruri po merr zhvillim të madh, duke vënë në rrezik prodhimin.

Alban Çakalli, ekspert për bujqësinë

"Sidomos te pemtoret është shumë problem për shkak se shumë pemë kanë filluar të çe-

sisht 30-40% të grurit."

Nga ana tjetër, temperaturat e larta po nxisin një prodhim më të hershëm të perimeve, duke bërë që në treg të kemi domate më herët nga sa jemi mësuar.

Alban Çakalli, Ekspert për Bujqësinë

"Tek perimet sjell mirë, këtë vit për shembull mund të kemi domate në mars, nga prilli që jemi mësuar. Por ndoshta kjo mund të jetë problem nga ana

mungesës së ngricave gjatë dhjetorit dhe në ditët e para të janarit insektet në kulturat bujqësore po shtohen.

Alban Çakalli, ekspert për bujqësinë

"Do të jetë problem për insektet sepse ngrica gjatë janarit është një cikël që dëmton pjesën më të madhe të dëmtuesve, por këtë vit do të kemi më shumë insekte, më shumë dëmtime dhe fermerët do të detyrohet të përdorin më shumë preparate për t'i luftuar."

Arben Dulellari, Drejtor i Bujqësisë, Bashkia Maliq

"Në kultura të ndryshme bujqësore kemi shtim të sëmudjeve dhe dëmtuesve. Kemi dëmtues të rinj të patateve, të misrit. Fermerët duhet të përshtasin kultivarë që i rezistojnë kushteve të disfavore, siç janë temperaturat e larta, thatësira e zgjatur, të mbjellin më herët që bima të rritet më e fuqishme dhe fazat delikate t'i kalojë më herët, me cikël më të shkurtër."



lin, që nuk është sezoni i qershisë për të çelur. Ka filluar edhe thana, edhe bimë të tjera kanë filluar të nxjerrin gjethe apo lulet prodhuese. Pemëtoret e kanë shumë të nevojshme ngricën në këtë sezon, arrorët, bërtahmorët, sepse çdo syth i kësaj peme do temperature të ulëta që të piqet sythi dhe më pas të kemi sezon të mbarë. Nëse gjatë prillit do të kemi ngrica dhe bimët i gjen të papërgatitura mund të ndodhë siç ndodhi para 3-4 vitesh kur shumica e pemëve u thanë dhe pjesa tjetër humbën prodhimin dhe kjo do të ndikojë që të kemi më pak prodhim. Te gruri është shumë problem sepse do të kemi zhvillim vegetativ jashtëzakonisht të madh dhe nëse do të ketë reshje gjatë sezonit të pranverës, bima nuk do të qëndrojë dot vertikalisht, do të rrëzohet dhe mund të kemi një humbje afër-

tjetër sepse nuk ka korrespondon sasia për të eksportuar sepse Shqipëria eksporton në muajin



prill dhe këtë vit mund të kemi prodhim edhe më herët. Hershmeria e tepërt mund të ndikojë që të mos kemi avantazhet e tregut për eksporte."

Në kushte të tilla, prej

Me shtimin e insekteve, fermerët do të detyrohen të përdorin më shumë pesticide për luftimin e tyre, por ekspertët bëjnë thirrje që përdorimi i tyre të jetë i kujdesshëm.

HISTORI NË BUJQËSI

Ndue Zaja nga Gjeggjani 'refuzon' qytetin për vreshtarinë: E kam pasion, por punoj dhe për të jetuar. Sa më shumë të rinj të kthehen te prindërit e vet aq më mirë

Ndue Zaja nga Gjeggjani i Pukës ka ngritur një vreshtari model, ku prodhon vere e raki në mënyrë artizanale. Në moshën 68-vjeçare vazhdon të kujdeset për tokën bashkë me bashkëshorten dhe nuk pranon të braktisë vendlindjen edhe pse fëmijët janë larguar prej vitesh

PUKË- Buzë lumit Fan, shtrihet një ndër fshatrat më të bukur në vend, Gjeggjani i Pukës. Këtu, Ndue Zaja ka ngritur me mundim 13 dynym vreshtari dhe prodhon 2 mijë litra vere çdo vit dhe rreth 700 litra raki.

"Kam kriju një vreshtë, kam rreth 2 mijë rrënjë hardhi 7-8

"Pemtari kam gështenja rreth 60 rrënjë në prodhim dhe arra 60 rrënjë që ende nuk kanë fillu prodhimin, kam dhe mollë, kumbulla, shega", shton Nduja.

68-vjeçari ka kryer studimet për mësuesi dhe ka punuar pak kohë në vitet 1974-'76, më pas në kooperativë bujqësore. Pas

këtë punë dhe nuk mendoj të largohem", rrëfen 68-vjeçari.

Pavarësisht kërkeses së fëmijëve të tij, për t'u zhvendosur në Lezhë, 68-vjeçari nuk pranon ta braktisë fshatin e lindjes. Mirëpo, problemi më i madh për Ndue Zajën dhe gjithë banorët e Gjeggjanit është mungesa e tregut.

"E kam shtëpinë në Lezhë, por çfarë të bëj atje, në katin e 8-të të pallatit? Këtu çohem dhe punoj, hap gropa, krasis hardhitë, ej. Nuk ka leverdi për t'i nxjerr në Fushë-Arrëz se duhet të paguash për transportin dhe s'kam as moshë të dal të shes. Duhet të ketë treg këtu brenda fshatit, që të vijmë t'i marrin produktet në fshat", thotë Nduja.

Rasti i këtij 68-vjeçari është një burim frymëzimi edhe për të rinjtë, që gjithnjë e më shumë po e braktisin vendin.

"E kam pasion, por punoj dhe për të jetuar. Sa më shumë të rinj të kthehen tek prindërit e vet aq më mirë, se ka 20 familje këtu në Gjeggjan që janë vetëm të moshuar, ka ikur rinia", përfundoi 64-vjeçari.



lloj rrushi merlot, sheshi i si zi dhe i bardhë, 200 rrënjë rrush tavoline të kuq të bardhë e të zi", tregon ai

E gjejmë duke u kujdesur për vreshtin dhe arrorët të cilët i shton çdo vit.

rënies së sistemit diktatorial u fokusua te vreshtaria, punën të cilën e vazhdon me pasion edhe sot.

"E përditja ime një kafe e raki pastaj merrem me punët e bujqësisë, ndjehem mire me

Bletaria, gjobat për shkeljet deri në 40 mijë lekë, si ndahen "ndëshkimet" sipas statusit amatorë apo profesionistë

Bletaria në vendin tonë është një sektor i cili prej vitesh bën thirrje për mbështetje më të lartë, duke qenë se ka vuajtur në të shkuarën nga ndikimi i pesticideve të përdorura pa kriter, mbështetje e ulët përmes granteve, si dhe konkurrenca nga produktet e importit.

Po përmes një priligji të ri, që pritet të nisë diskutimet këtë vit, krahas mbështetjes, janë parashikuar qartazi edhe ndëshkimet administrative për këtë sektor, ku bëhet një ndarje mes prodhuesve amatorë dhe ata profesionalë. Ky diferencim është bërë pasi bletarët amatorë kanë një numër të kufizuar zgjojesh dhe nuk prodhojnë mjaltë me qëllim tregtimin për konsumatorët. Ndaj, gjobat duhet të jenë në proporcion me ndikimin që ato kanë, pra, më të ulëta në vlerë se për bletarët profesionistë. Nga ana tjetër, bletarët profesionistë zotërojnë numër të pakufizuar zgjojesh, prodhimi i tyre vijon në zinxhirin ushqimor deri te konsumatori.

Sipas relacionit të specifikuar, masat janë për këto shkelje:

bletarët pa qenë të regjistruar në regjistrat publikë dhe konkretisht të fermës dhe të blegtorisë. Të dy regjistrat janë aktivë dhe kanë informacionet e mbledhura nga institucionet por me këtë ligj bletarët marrin qartë detyrimin për t'u regjistruar dhe përditësuar të dhënat. Mungesa e plotësimit të të dhënave përbën kundërvajtje dhe gjobitet sipas nenit vijues.

– Vendosja e parkut pa ruajtje distancat përbën po ashtu kundërvajtje dhe gjobitet.

– Lëvizja e parkut pa miratimin e institucionit përgjegjës dhe pa certifikatë veterinarë të lëvizjes përbën një tjetër kundërvajtje. Certifikata lëshohet pas kontrollit që veterineri zyrtar kryen dhe shoqërohet me masat veterinarë përkatëse.

Lëvizja duhet të bëhet pas njoftimit dhe marrjes së miratimit nga institucioni përgjegjës për veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve, në të kundërt përbën kundërvajtje administrative. Duhet theksuar se territori i Shqipërisë është i mbuluar me veterinerë zyrtarë të cilët i përgjigjen në kohë nevojave.

– Mosnjoftimi i institucionit përgjegjës në rast dyshimi të sëmundjeve sipas parashikimit të nenit 11, të këtij ligji

Shkeljet e parashikuara konsiderohen kundërvajtje administrative dhe masat merren bazuar në këtë ligj. Nëse gjatë kontrolleve dhe inspektimeve evidentohen shkelje të parashikuara në ligje të tjera, ato janë të aplikueshme sipas parashikimeve të tyre.

Sipas specifikave, masat janë:

a) Për shkeljet e parashikuara në shkronjën "a", për bletarët amatorë gjobë nga 2 000 lekë deri në 5 000 lekë, ndërsa për bletarët profesionistë nga 5 000 lekë deri në 20 000 lekë.

b) Për shkelje e parashikuara në shkronjën "b", për bletarët amatorë gjobë nga 2 000 lekë deri në 5 000 lekë, ndërsa për bletarët profesionistë nga 5 000 lekë deri në 30 000 lekë.

c) Për shkelje e parashikuara në shkronjat "c" dhe "ç", për bletarët amatorë gjobë nga 2 000 lekë deri në 5 000 lekë, ndërsa për bletarët profesionistë nga 10 000 lekë deri në 40 000 lekë.

FED INVEST

Finalja e Elevator Lab, Aba Online fituese e çmimit të madh

Jemi krenarë sot për arritjet e ABA Online, duke fituar çmimin e parë në edicionin e gjashtë të Elevator Lab Albania, organizuar nga Raiffeisen Bank Albania!

Elevator Lab është programi më i madh i partneritetit fintech dhe startup në Evropën Qendrore dhe Lindore. Pro-

grami u ofron startup-eve, me produkte dhe teknologji inovative të dëshmuara, një hyrje të strukturuar katër mujore dhe një projekt provues të konceptit (PoC) me ekspertët kryesorë bankar, me qëllim krijimin e bashkëpunimit të mëtjetshëm. Deri më tani, Elevator Lab financoi plotësisht 25 PoC për të zhvilluar bizneset e tyre dhe për t'u mundësuar rritje ndërkombëtare, gjithë që rezultoi në 15 partneritete afatgjata në të gjithë RBI Group.



Mes 8 konkurrentësh të risive dhe inovacioneve teknologjike, ABA Online u përzgjedh si biznesi më Smart në sektorin bankar dhe financiar aktual.

Aba Online, u shpall start-upi fitues i Elevator Lab 2022 me çmimin prej 5000 euro. Në mbrëmjen finale u prezantuan 8 startupe me me ide inovative në fushën e teknologjisë. Idetë amicioze u ndoqën nga një juri e përzgjedhur, drejtues të institucioneve të ndryshme, kryesuar nga Raiffeisen Bank. Ky panel u moderua nga CEO i Raiffesien Bank Z. Christian Canacaris.

Objektivi i këtij startup-i është të përmirësojë qëllimet për fermerët, të krijojë grupe dhe t'u japë mundësinë e një



Platforma ABA online është e aksesueshme në web edhe në app dhe jep shërbime jo financiare për fermerët në të gjithë

Shqipërinë pa kosto. Eldi Çeço, menaxher i platformës ABA online thekson se, "deri tani, platforma ka pasur një ecuri të mirë, pasi ka mbi 15 mijë të regjistruar, 80% e të cilëve janë fermërë, 10% janë tregtarë inputesh dhe 10% janë konsumatorë".

Planet e këtij startup-i janë shumë ambicioze. "Ne mendojmë që të fusim edhe shërbime të tjerë si, për shembull t'i ndihmojmë fermerët të bëjnë aplikimin për grand-e qeveritare, t'i ndihmojnë për të kryer transaksione financiare, blerje, shitje, meqënëse në platform kemi edhe tregun online, t'i ndihmojmë me ekspertizën e ekspertëve që kemi në

platformë si dhe të jemi pika e parë e kontaktit për çdo fermer shqiptar", thekson manaxheri i ABA online.

Eksportuesit e bimëve medicinale kërkojnë analiza të akredituara nga shteti; Kote: Do jenë gati në ISUV nga mesi i 2024-s

Nga mesi i vitit të ardhshëm edhe eksportuesit e bimëve medicinale do të mund të kryejnë analizat e akredituara për njohje në vendet e BE-së pranë laboratorëve shtetërorë.

Mungesa e laboratorëve të akredituar shtetërorë për kryerjen e analizave në përputhje me kërkesat e shtuara të vendeve të BE-së, veçanërisht Gjermanisë ku eksportohen 32% e bimëve të mbledhura, krijoi që në 2022 të ktheheshin mbrapsht 45 kamionë me bimë medicinale.

Zv.ministri i Bujqësisë

Dhimo Kote tha për Monitor se kjo problematikë, veçanërisht te bimët e kultivuara do të zgjidhet shumë shpejt nëpërmjet akreditimeve të reja pranë ISUV.

"Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarë (ISUV) kryen rreth 1,368 analiza të akredituara sipas standardit ISO/IEC 17025:2017 për njohje ndërkombëtare. Nga këto janë kryer 450 analiza aktive për lëndën e mbetjes në produkte.

Është në qendër të vë-

mendjes që për këtë vit për bimët medicinale në bashkëpunim edhe me GIZ t'i kryejnë analizat pranë ISUV. Pra të gjithë prodhuesit dhe përpunuesit e bimëve medicinale do t'i çojnë mostrat pranë laboratorit shtetëror ISUV, kundrejt tarifave shtetërore për çdo shërbim që do të kërkohet.

Pra ne kryejmë analizat e akredituara për njohje ndërkombëtare, por që të

(Vijon në faqen 7)

Qendër e zhvillimit për gratë artizane në Kavajë

Së shpejti në Bashkinë Kavajë do të funksionojë Qendra e Zhvillimit të Artizanatit.

Bashkia Kavajë, dhe Grupi i formalizuar i grave artizane arritën të finalizojnë Marrëveshjen e Mirëkuptimit "Për Ngritjen dhe Funksionimin e Qendrës së Artizanatit në Bashkinë Kavajë".

Qendra është një ambient punë në ambientet e Shkollës së mesme të përgjithshme "Aleksandër Moisiu", që do të përdoret, zhvillohet dhe mirëmbahet nga gratë artizane të qytetit të Kavajës të përfshira në zinxhirin e vlerës së artizanatit.

Qendra do të nxisë zhvillimin e mjeshtërive të artizanatit lokal tradicional, transferimin e njohurive dhe aftësive të brezi i ri, përmirësimin e aftësive teknike të artizanëve, informimin mbi zhvillimet më të fundit në zeje dhe punët artizanale si dhe ofrimin e mundësive për aktivitete shkëmbyese e promovuese dhe

përmirësimin e marketimit.

Qendra do të funksionojë bazuar në rregulla dhe plane që ofrojnë mundësi gjithëpërfshirëse për gratë artizane,



anëtare të grupimit ligjor të grave artizane, për të aksesuar hapësirën, mjetet e punës dhe mundësitë e tjera;

Në vazhdim Qendra do të pajiset me bazën materiale në disa mjeshtëri kryesore të artizanatit që praktikohen nga gratë artizane pjesë e grupimit

të formalizuar.

Projekti "Fuqizimi ekonomik i grave në zinxhirin e vlerës së artizanatit në Bashkinë e Kavajës" mbështetet

nga UN Women Albania përmes Projektit me Ndjesmëri Gjinore për Rikuperimin dhe Rindërtimin pas Tërmetit, me fonde të qeverisë suedeze përmes Fondit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

Eksportuesit e bimëve medicinale kërkojnë analiza të akredituara nga shteti; Kote: Do jenë gati në ISUV nga mesi i 2024-s

(Vijon nga faqja 6)

marrësh analiza shtesë në përputhje me kërkesat e shtuara të BE-së, nevojitet akreditimi dhe trajnimi i trupës. Nga diskutimet që kemi pasur edhe me drejtues të ISUV pritet që fazat e nevojshme t'i kalojmë shumë shpejt. Mendoj se nga mesi i vitit që vjen kjo çështje do të zgjidhet", pohoi ai.

Aktualisht në Shqipëri funksionon vetëm një laborator privat i akredituar për kryerjen e analizave specifike për bimët medicinale që eksportohen jashtë.

Kryetari i shoqatës së Bimëve Medicinale dhe Aromantike Filip Gjoka kërkoj zgjidhjen e kësaj problematike me ngritjen e laboratorëve shtetërorë për kryerjen e analizave për një gamë të gjerë të bimëve medicinale të prodhuara në vend me distancë eksporti, pasi janë shtuar vështirësitë për kompanitë

shqiptare.

Në 2021 eksportet e bimëve medicinale sipas të dhënave të Doganave ishin në vlerën

por nëse do të kishte më tepër investime në kapacitetet përpunuese vlera e tyre parashikohet të rritet 30 deri 40%.



e 5,4 mld lekëve. Krahasuar me 2020 eksportet u rritën 6% më shumë. Totali i eksporteve për 2022 sipas Shoqatës së Bimëve Medicinale dhe Aromantike është rreth 6,2 mld lekë rreth 14% më shumë se 2021,

Destinacioni kryesor i eksporteve është Gjermania. Për 2021 rreth 32% e produkteve të këtij grupi u eksportuan në Gjermani, SHBA dhe rreth 10% e tyre në Turqi dhe Francë.

Bashkia e Fierit mbështet dhe inkurajon zhvillimin e blegtorisë në territorin e saj. Janë krijuar edhe investime model në këtë drejtim

Krijimi i lehtësirave në zhvillimin e blegtorisë është një nga synimet dhe qëllimet e punës së pushtetit vendor në bashkinë e Fierit. Ato janë të shumta në numër dhe kanë krijuar një profil të qartë zhvillimi. Tashmë investitorët synojnë krijimin e një biznesi me cikël të mbyllur.

Një nga këto biznese në fushën e blegtorisë është kompania

"Allidagu", e cila i përket atyre sipërmarrjeve që vijnë nga një përpjekje titanike disa vjeçare, sakrificash dhe sfidash, për të ardhur në ditët e sotme si një aktivitet kampion në nivel kombëtar, të mbarështimit të derrit.

Kjo kompani përveç mbarështimit në investimin e saj ka krijuar një cikël të mbyllur prodhimi me produkte tërësisht vendase dhe bio. Për-

pos kësaj në bashkinë e Fierit funksionon një nga tregjet më bashkëkohore në rang vendi për tregtimin dhe therjen e bagëtive.

Në këtë treg prej muajsh vijonë tregtarë jo vetëm nga fieri dhe rrethinat e saj, por edhe nga bashkitë të tjera duke i dhënë kështu parametrat e një tregu rajonal me kapacitete të konsiderueshme tregtimi.

Prezantim i një rasti studimor: "Aplikimi i Zgjidhjeve Digjitale dhe IoT në Sektorin e Përpunimit të Qumështit dhe Fermave Blegtorale"

Këshillat për Bizneset e Vogla të BERZH, në bashkëpunim me Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë, zhvilluan në platformë virtuale sesionin e fundit informues për aftësimin digjital dhe përdorimin e teknologjisë IoT.

Në këtë seminar morën pjesë rreth 22 përfaqësues nga agrobiznesi, kryesisht me fokus përpunimin e qumështit, fermat blegtorale, agjenci zhvillimi, konsulentë etj.

Blegtorja është një sektor i cili ka ende nevojë për rritjen e cilësisë, standardeve dhe zhvillimin e zinxhirit deri të konsumatori final. Ndaj ne mbështesim këto Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme, përmes informimit me raste konkrete

që të njihen me praktikën më të mira në përshtatje me zhvillimet më të fundit teknologjike dhe IoT.

Gjithashtu pjesëmarrësit u njohën me instrumentet financiare në agrobiznes nga përfaqësuesit e Bankave Partnere të BERZH, në kuadër të implementimit të Programit për Zhvillimin e Agrobiznesit dhe Turizmit në Shqipëri (AATSF), të mbështetur nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Qeveria Shqiptare.

Në seminarin e fundit të ciklit prej katër seminaresh, në datën 10 Nëntor 2022, do të prezantohet një rast studimor konkret i aplikimit të zgjidhjeve digjitale dhe IoT në fushën e Përpunimit të Qumështit

dhe Fermave Blegtorale.

Në këtë seminar online, SME-të pjesëmarrëse, të cilat operojnë në sektorin e agrobiznesit, me fokus të veçantë tek përpunuesit e qumështit, fermat blegtorale dhe shërbimet e lidhura, do të kenë mundësinë të informohen mbi përfitimet nga zbatimi dhe investimi në praktikën më të mira të masave për menaxhimin efektiv të operacioneve në përshtatje me zhvillimet teknologjike.

Ky seminar organizohet në kuadër të zbatimit të programit të "Mbështetjes së Agrobiznesit dhe Turizmit në Shqipëri", të mbështetur nga BERZH, Bashkimi Evropian (BE) dhe Qeveria e Shqipërisë

Seminari 4
PREZANTIM I NJË RASTI STUDIMOR:
Aplikimi i zgjidhjeve digjitale dhe IoT në sektorin e përpunimit të qumështit dhe fermave blegtorale

10 Nëntor 2022, ora 10:00
Regjistrohuni në Google Meet

Bashkia e Fierit drejt ambicieve të saj për një bujqësi dhe blegtori moderne dhe funksionale. Sot prodhimet fierake të vlerësuara në Europë

Asnjë pëllëmbë tokë mos të mbetet në Myzeqe pa u punuar dhe pa marrë të mirat materiale për plotësim të

e këtij sistemi duke iu krijuar kështu mundësinë gjithë fermerëve të bashkisë së Fierit ta punojnë dhe t'i gëzohen

serave.

Për herë të parë për bujqësinë fierake është shënuar arritja e madhe ndër vite ku vaditja nuk ka qenë problem për fermerët. Këto arritje janë mundësuar falë investimeve që ka bërë bashkia në bashkëpunim edhe me qeverinë qendrore.

Në çdo njësi administrative do të ndeshesh me iniciativë të suksesshme si në drejtim të bujqësisë, blegtorisë, rritjes dhe kultivimit të varieteteve të perimeve dhe frutave, por edhe ato të përpunimit të prodhimit shtazor.

Investimet në mënyrë të veçantë në infrastrukturën rrugore si në akset kryesore, por edhe në ato lidhëse kanë krijuar një mundësi të vlefshme për fermerët në drejtim të tregtimit të prodhimeve të tyre në tregjet rajonale, por edhe në pikat e grumbullimit të ngritura dhe që funksionojnë normalisht si në bujqësi apo blegtori. Sot fermerët dhe blegtorët fierakë janë ngritur në nivele të larta bashkëpunimi dhe me firmat në mbarë vendi.



nevoja rajonale, por edhe në drejtim të tregut evropian. Në plotësim të kësaj ambicije në mënyrë të vazhdueshme bashkia e Fierit në kujdesin e veçantë të kryetarit të bashkisë Armando Subashi po çelen do ditë kantiere të investimit në drejtim të sistemit kullues dhe vaditës.

E fuqizuar me një mekanikë bashkohore, bashkia e Fierit kryen me forcat e veta dhe me fondet e veta sistemin

të ardhurave në rritje.

Aktualisht Fieri pa frikë mund të cilësohet si toka e historive të suksesit të biznesit në fushën e bujqësisë dhe agropërpunimit. Në sajë të investimeve vetjake, por edhe përfitues të grandeve të dhëna nga qeveria shqiptare, sot në çdo stinë të vitit toka është e punueshme dhe me rendimente të kënaqshme. Ato kultivohen si në natyrë të hapur, por edhe në sistemin e



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



**MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



VAJI I ULLIRIT

Mbiprodhimi i vajit të ullirit që rrezikon bumerangun

Mbiprodhimi i vajit të ullirit në vitin 2022 parashikohet të kthehet në bumerang për Shqipërinë. Fabrikat kanë ulur kapacitetin grumbullues, pasi vaji i ullirit tregtohet më tepër në informalitet me çmim të ulët. Eksportet vijojnë të mbeten në sasi të ulëta, nga luhatshmëritë drastike të prodhimit nga viti në vit dhe pamundësia e kompanive për të paguar garancitë që kërkojnë tregjet e mëdha. Mungesa e tregut rrezikon që fermeri të braktisë rritjen e ullinjve. Zgjidhja te investimet në kapacitetet ruajtëse

reja të ullirit dhe të shërbimeve që fermerët kanë bërë me ullirin dhe kushtet klimatike.

Këtë vit, kultura e ullirit është përfshirë edhe në skemën e subvencioneve të Ministrisë së Bujqësisë, duke përfshirë, për herë të parë, rimbursimin e barrës fiskale edhe për fermerët që kultivojnë ullirin.

Masa mbështetëse nr. 5 mbi përdorimin e fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural parashikon subvencionimin në masën 50% të vlerës totale të faturës tatimore për ullirin e mbjellë, por jo më shumë se 175,000 lekë, në sipërfaqe jo më pak se 1 ha dhe jo më shumë se 500,000 lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 ha në fushë të hapur.

Pse mungon tregu i shitjes së vajit të ullirit?

Mbiprodhimi ka krijuar kaos në tregun e shitjes së vajit të ullirit. Drejtues të fabrikave përpunuese pohojnë se, nëse prodhimi i vajit është deri 40% më i lartë se viti paraardhës, rrezikon të kthehet në bumerang, pasi mungon tregu i brendshëm për shitje, ndërsa eksportet vijojnë të jenë në sasi të ulëta.

Në tregun e brendshëm, informaliteti vijon të mbetet i lartë për sektorin prodhues të vajit të ullirit. Shumë fermerë e shesin vajin e ullirit në tregun e zi të paambalazhuar. Burime nga përpunuesit e vajit të ullirit thanë se 95% e produktit shitet në informalitet, vetëm 5% e tij shitet në supermarkete.

Dëmtimi i konkurrencës nga informaliteti i lartë, si dhe kostot e larta administrative, duke përfshirë ambalazhimin dhe taksat, e ka kthyer produktin e formalizuar të paleverdishëm nga çmimi.

Ylli Hajdini, administratori i kompanisë “S.E.D – Borshi”, një ndër prodhuesit e mëdhenj të vajit të ullirit, pohon se deri tani nga ullinjët që u ka blerë fermerëve shqiptarë disponon në depozita 150 deri në 160 tonë vaj ulliri.

Edhe pse zotëron kapacitet për rritjen e përpunimit, z. Hajdini nënvizon se nuk mund të blejë më tepër sasi, pasi tregu është i mbingopur nga vaji i fermerit, ndërsa shitjet në supermarkete të vajit të ambalazhuar shqiptar janë në minimum. Situata është krijuar nga çmimi.

“Vajin e ullirit të fabrikat e përpunimit, fermerët e shesin me çmim 400 deri në 420 lekë për litër. Duke i shtuar vajit të blerë 360 lekë për litër, kostot administrative (që përfshijnë detyrimet fiskale, pagat e punonjësve, energjia, karburantet.

Ndërsa 75 deri në 110 lekë varion vetëm kostoja për blerjen e ambalazhimit, si shishet e qelqit dhe tapat dhe etiketat). Kosto tjetër e shtuar është prej 160 lekë për litër është edhe TVSh në shitje, prej 20%. Me heqjen e skemës së kreditueshme, gjithë barrën e TVSh-së e mban grumbulluesi.

Bazuar mbi këto kosto, çmimi i përpunimit të vajit të ullirit arrin në 760 lekë për litër. Përpunuesi e shet në supermarkete vajin me çmim 800 deri në 820 lekë për litër. Nga supermarketet, duke përfshirë edhe normën e tyre të fitimit, shitet 980 deri në 1,000 lekë për litër.

Në këtë situatë, konsumatori do të kërkojë të blejë vaj ulliri me çmim 500 deri në 600 lekë për litër që po shitet drejtpërdrejt nga fermeri apo 1,000 lekë për litër që tregtohet në supermarkete?”

Z.Hajdini shton se në vend nuk ka fuqi konsumatore për kaq shumë vaj të prodhuar, për shkak të traditës së konsumit të ulët të vajit në vend, krahasuar me fqinjët dhe Europën.

Në Shqipëri, për shkak të informalitetit të lartë, konsumi i vajit të ullirit është i pamatshëm. Sipas vlerësimeve për 25,882 tonë vaj ulliri të prodhuar në 2021, duke pasur parasysh popullsinë, konsumi i dukshëm i vajit të ullirit për frymë vijon të jetë më pak se 1 litër në vit.

Në Europë, sipas të dhënave të Qendrës Europiane të Importeve (CBI) konsumi i vajit të ullirit u vlerësua në 1,46 milionë tonë në vitin 2021, që është afërsisht gjysma e konsumit të përgjithshëm botëror. Italia dhe Spanja janë konsumatorët më të mëdhenj të vajit të ullirit në BE, me konsum vjetor prej rreth 500,000 tonësh secili, ndërsa Greqia ka konsumin më të madh të BE-së për frymë, me rreth 12 kg për person në vit.

Konsumi për frymë i vajit të ullirit në vendet e BE-së me përjashtim të Italisë, Spanjës, Portugalisë dhe Greqisë parashikohet të rritet me rreth 4% në vit, por do të mbetet relativisht i ulët (1.3 kg/person deri në vitin 2025).

Në të njëjtën kohë, konsumi mesatar për frymë në Itali, Spanjë, Portugalinë dhe Greqinë është më i ulët (1.3 kg/person deri në vitin 2025).

Heqja e skemës së TVSH-së shtoi kostot e përpunuesve

Heqja e skemës së kreditueshme të TVSH-së nga 1 janari 2022 dëmtoi edhe industrinë e përpunimit të vajit.

Për disa grumbullues, problemi kryesor në këtë industri mbetet shtimi i kostove nga moskreditimi i TVSH-së.

“Skema e TVSH-së së kreditueshme filloi të krijojë probleme që në vitin 2019. Prodhuesit me xhiro mbi 14 mln lekë në vit për blerjet e ullinjve të fermerit rimbursosheshin 6%, ndërsa në momentin që vaji shitet me 20% TVSH, humbjet janë 14%.

Me heqjen e TVSH-së së kreditueshme, kostot e prodhuesit në shitje janë të larta, si rezultat interesi për të grumbulluar më shumë ullinj ka rënë”, pohoi në anonimat një grumbullues dhe përpunues i vajit të ullirit në zonën e Beratit.

Pse nuk eksportohet vaji i ullirit

Shqipëria vijon të eksportojë vaj ulliri në sasi shumë të ulët. Për përfaqësuesen e fabrikës përpunuese “Subashi”, luhatshmëria e prodhimit nga njëri vit në tjetrin mbetet faktori kryesor për eksportet e ulëta.

“Kjo vjen për shkak të copëzimit të madh të ngastrave të ullirit dhe problematikës së krijuar me ligjin nr. 7501 për ndarjen e tokës bujqësore. Në total janë 44 mijë fermerë që kultivojnë në ngastra tokë nga 50 deri në 500 rrënjë ulliri. Fermerët me 40 deri në 50 rrënjë ulliri operojnë në informalitet”, pohon Silvana Subashi.

Znj. Subashi rekomandon se vetëm ngritja e grupeve për bashkimin e të mbjellave me ullinj nga fermerët do të jepte efekt të rritja e eksporteve dhe ulja e kostos së prodhimit. “Fermerët duhet të bashkohen me njëri-tjetrin, ngastrat e ullirit duhet të jenë më të mëdha, pasi ndryshimet e prodhimit nga njëri vit në tjetrin janë të mëdha.

Ka grumbullues, por nuk ka prodhim dhe nuk mjaftojnë burimet njerëzore për ta zhvilluar më shumë këtë kulturë. Prandaj krijimi i një grupi prodhues do të mundësonte mbylljen e ciklit, do të zgjidhte edhe problemin e fuqisë punëtore dhe të eksportit, pasi do të garantohej prodhimi”, pohon ajo.

Për sa u përket eksporteve, disa përpunues vendas po shohin mundësinë e zhvillimit të kontratave në vendet joprodhuese të vajit të ullirit, siç është SHBA. Ylli Hajdini, nga kompania “Borshi”, thotë se eksportet zënë gati 10% të prodhimit.

Kompania, përveçse në SHBA eksporton edhe në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë. Sipas tij, arsyeja kryesore e eksporteve të ulëta mbetet

moskrijimi i markës shqiptare të vajit të ullirit dhe mungesa e konkurrueshmërisë nga çmimet e larta që vijnë nga kostoja.

Për shtetet e largëta, siç është SHBA, rritja e sasisë së eksportuesve duhet të shprehë me shtimin e pagesës së garancisë që arrin deri në 1 mln USD, po kjo vlerë është e papërballueshme nga përpunuesit shqiptarë.

Në botë, Spanja është prodhuesi dhe eksportuesi më i madh i vajit të ullirit me një pjesë prej 49% në vitin 2021, e ndjekur nga Greqia (13%), Italia (11%), Tunizia (11%) dhe Portugalia (10%).

Sipas Agjencisë së Informacionit dhe Kontrollit të Ushqimit (AICA), Spanja prodhoi 1.3 milionë tonë vaj ulliri në vitin 2021, që përbën 42% të prodhimit global të vajit të ullirit. Italia është prodhuesi i dytë më i madh i vajit të ullirit në botë, me rreth 315 mijë tonë në vitin 2021.

Prodhues të tjerë të mëdhenj të vajit të ullirit janë Tunizia (240 mijë tonë), Turqia (228 mijë tonë), Greqia (225 mijë tonë) dhe Maroku (200 mijë tonë). Këto gjashtë vende, përkatësisht Spanja, Italia, Tunizia, Turqia, Greqia dhe Maroku, janë përgjegjëse për 81% të prodhimit global të vajit të ullirit.

Shtohen rrënjët e ullirit, por bie rendimenti

Sipas të dhënave të INSTAT, numri i rrënjëve të reja të ullirit në vitin 2021 është rritur rreth 2% krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa rendimenti i prodhimit ka shënuar rënie 18% në vitin 2021 në raport me 2020.

Sipas përpunuesit të vajit të ullirit, Ylli Hajdini, rendimenti i ulët dhe prodhimi me kosto të lartë vjen për shkak të copëzimit të lartë të tokës bujqësore dhe mungesës së automatizimit të procesit të prodhimit të kësaj kulture.

Zv.ministri i Bujqësisë, Dhimo Kote, tha se për t'i dhënë zgjidhje uljes së kostos së prodhimit synohet të shkohet drejt grupimit të ngastrave të tokës që përmbajnë 200 apo 300 rrënjë ullinj dhe ngritjes së pikave të rafinimit të vajit të ullirit.

Edhe sipas një analize të vitit 2012 për sektorin e ullirit nga Komisioni Europian, për Shqipërinë nuk mund të prodhohet në vëllime të mjaftueshme, në mënyrë që të jetë një lojtar i rëndësishëm në tregun e BE-së, për shkak të fragmentimit ekstrem të pemishteve të ullirit.

Madhësia mesatare e pemishteve, vëren raporti, është 0.2-0.4 hektarë, krahasuar në

një madhësi mesatare prej 1.6 hektarësh në Greqi. Ky copëzim e bën prodhimin joefikas dhe të paafte për të përfutur nga ekonomia e shkallës. Si pasojë e kësaj situatë, Shqipëria do të vazhdojë të prodhojë në sasi të vogla vaj ulliri dhe me kosto të lartë.

Studimi sheh të përshtatshëm prodhimin e vajit organik të ullirit, i cili favorizon cilësinë mbi volumin. Rreth dy të tretat e pemishteve të ullirit të Shqipërisë besohet të jenë organike, por vetëm 1% e pemishteve, ose 515 hektarë, janë certifikuar si të tillë.

Për më tepër, prodhuesit shqiptarë ballafaqohen me kufizimet rregullatore për të eksportuar në BE. Agronomët shqiptarë kanë mungesë njohurish për trajtimin e prodhimeve organike me standardet e BE-së.

Çfarë do të ndodhë me superprodhimin

Silvana Subashi, një ndër njohëset e sektorit përpunues të vajit të ullirit, pohon se fermerët po e shesin vajin nën kosto, për shkak të mbiprodhimit, gjë që rrezikon të sjellë vite të vështira më pas, pasi fermerët nuk do të kenë interes t'i shërbejnë pemës së ullirit me këto lloj çmimesh.

Znj. Subashi parashikon që çmimi i vajit të ullirit të rritet disa herë më shumë se nga çmimi i këtij viti.

Nëse vaji ruhet në kushte optimale, produkti këshillohet të konsumohet brenda 24 muajve. Ndër të tjera, përfaqësuesja e kompanisë “Subashi” shton se konsumi i brendshëm i vajit të ullirit duhet të rritet, kryesisht falë fushatave ndërgjegjësuese për konsumatorin dhe përfshirjen e vajit të ullirit në të gjithë shoqërinë shqiptare, për shkak të vlerave ushqyese.

Të ardhurat e kompanive

Të ardhurat e kompanisë së përpunimit të vajit të ullirit “Sidnej” në 2021 ranë 1% krahasuar me 2020. Edhe fitimet pësuat rënie në të njëjtin nivel.

Të ardhurat e kompanisë së prodhimit të vajit të ullirit “Dhërmiu” në vitin 2021 ishin me rënie 18%, ndërsa fitimet e kompanisë u reduktuan në masën 43% në raport me vitin paraardhës, sipas bilanceve zyrtare të dorëzuara në QKB.

Rënie të të ardhurave shënoi në vitin 2021 edhe kompania “S.E.D- Borshi”. Të ardhurat e këtij operatori ranë 12%, ndërsa fitimet u tkurrën 32%.

Për prodhuesit më të vegjël të vajit të ullirit, siç është kompania “Çuedari”, të ardhurat në 2021 u rritën 40% më shumë se 2020. Fitimet e kompanisë ishin me rritje 78% më shumë.

Të ardhurat e “Shkalla Sh” në 2021 u rritën 9% dhe fitimet 41%. Operatori “GJK- ONDI & KOMPANI” në vitin 2021 shënoi ulje të të ardhurave 13% më pak se në 2020-n, ndërsa fitimet u rritën rreth 2,5 herë më shumë se viti paraardhës.

Revista “Monitor”

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë me financim të MBZHR që nga viti 2009 dhe në vazhdim po implementon programin "Menaxhimi i Qëndrueshëm të Tokës Bujqësore" mbi krijimin e sistemit të informacionit për tokën (LIS) dhe integrimi në sistemin e informacionit gjeografik (GIS).

Në këtë sistem ndër të tjera është mundësuar të krijohet database mbi përdorimin e tokës sipas funksionit bazuar në vitin që është bërë studimi, i krahasuar me vitin e regjistrimit fillestar të tokës për njësitë administrative. Informacioni i krijuar në nivel të njësisë administrative është shtrirë në rreth 70% të sipërfaqes të tokës bujqësore në shkallë vendi. Studimi i krijuar është dorëzuar pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) në qarkun respektiv në funksion të Zyrrave të Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) në njësitë administrative me synimin që të shfrytëzohet për një planifikim rentabël të përdorimit të tokës bujqësore, për zhvillimin urban dhe mjedisor të njësisë administrative.

Problematikat që janë hasur në studim për tokën janë të ndryshme dhe kjo është në varësi të qarkut, rajonit dhe njësisë administrative. Në shumë njësi administrative të vendit vërehet lënia e tokës djerrë kjo për faktin se popullsia ka lëvizur në zonat urbane si dhe tokave me pjellori të kufizuar.

Le të analizojmë ndryshimet e kategorive të përdorimit të tokës në njësitë administrative Velabisht dhe Sinjë të qarkut Berat.

DOMOSDOSHMERIA E PËRDITËSIMIT TË KATEGORIVE TË TOKËS NË NJËSITË ADMINISTRATIVE

Kategoria e Tokës	Njësia administrative Velabisht		Njësia administrative Sinjë	
	Sipërfaqja/Ha		Sipërfaqja/Ha	
	Viti i regjistrimit 1998	Viti i studimit 2017	Viti i regjistrimit 1997	Viti i studimit 2017
Bujqësore	4854	4839.7	3572	3546
Kullotë	1068.1	1085	5093	5109.7
Pyll	1657.6	1657.6	4366.6	4366.6
Jo bujqësore	1141.2	1139.2	600.5	609.5

Të dhënat e mësipërme vërtetojnë edhe njëherë uljen e sipërfaqes së kategorisë tokë bujqësore dhe rritjen e sipërfaqes së tokës për zërin kadastral kullotë ose tokë jobujqësore në të dy njësitë administrative. Gjithsesi ndryshimet në sipërfaqe ndërmjet zërave kadastrale nuk janë shumë të dukshme, por të dhënat e mëposhtme tregojnë se kemi ndryshime brenda zërit kadastral tokë bujqësore dhe konkretisht;

Po të analizojmë ndryshimet në kategorinë e tokës bujqësore në njësinë administrative Velabisht, nga 55% e sipërfaqes së tokës që zë toka arrë në vitin 1998, zvogëlohet në 38% në vitin 2017. Gjatë kësaj periudhe konstatohet që është rritur sipërfaqja

e tokës me ullishte në masën 20%.

I njëjti fenomen është konstatuar në njësinë administrative Sinjë, nga 89% e sipërfaqes së tokës që zë toka arrë në vitin 1997 zvogëlohet në 61% në vitin 2017, ndërsa sipërfaqja e tokës me ullishte nga 9% në vitin 1997 rritet në 38% në vitin 2017. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i politikës mbështetëse me subvencione për fermerët që ka ndjekur Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Pyetja shtrohet nëse është kryer përditësimi i informacionit për ndryshimet në kategoritë e tokës apo ndryshimet në kategorinë e tokës bujqësore pas kësaj periudhe në këto njësi administrative apo në

njësitë administrative në shkallë vendi?

Nga Drejtoria e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave në QTTB Fushë Krujë nëpërmjet Programit "Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore" është mundësuar dixhitalizimi i regjistrit të tokës bujqësore dhe kategorive të tjera të reser-suve në këto njësi administrative ose në 66% të njësisive administrative në shkallë vendi.

Regjistri dixhital lehtëson shumë përditësimin e këtij informacioni, por kërkohet përgjegjësi nga specialistët e Zyrrave të Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës në njësitë administrative në zbatimin e udhëzimit Nr. 11 datë 14.06.2011 "Për mënyrën e verifikimit dhe të ndryshimit të zërave kadastrale të tokës bujqësore" ku në mënyrë eksplicite detyron specialistët e ZMMT të bëjnë përditësimin çdo vit të përdorimit të tokës.

Një sistem i përditësuar është i vlefshëm për fermerët duke u dhënë informacion, që të investojnë në produkte që janë të kërkuar në treg, për politikën e MBZHR një situatë reale që të adresojë skemat mbështetëse në drejtimin e duhur dhe në ofrimin e të dhënave në funksion të vjetarit statistikor etj.

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në zbatim të detyrave që ngarkon VKM 515 është e gatshme të ofrojë trajnime të specialistëve të ZMMT në njësitë administrative në mënyrë të vazhdueshme mbi përditësimin e ndryshimeve të përdorimit të tokës bujqësore dhe kategorive të tjera të resurseve.

Përgatitën: Suada Luzati; Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë dhe i Përdorimit të Tokës Shpëtim Tafaj; Drejtor i Shërbimit të Tokës dhe Ujërave

Drejtorja e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave;

QTTB-Fushë Krujë: E-mail: qttbfushekrue@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

Krasitja dimërore në hardhi:

• Një thënie e vjetër për vreshtarinë e mjaft e rendësishme për krasitjen e saj është "Të më punojë kush të dojë, por të më krasitë imzot".

• Krasitja si koncept: është një tërësi operacionesh për të pakësuar një pjesë të kurorës që tashmë ka frutifikuar dhe detyrojmë pjesën tjetër për zhvillim vegetativ dhe prodhim.

Qëllimet kryesore të krasitjes:

- Realizohet një formë e stabilizuar e hardhisë lidhur me: -Pjellorinë e tokës, -Kushtet klimatike si dhe -Tipi i vreshtit.

- Vendoset një raport i drejtë midis masës vegetative dhe prodhimit.

- Disiplinohet zhvillimi në pjesë të ndryshme të bimës.

- Realizohet ekuilibri i nevojshëm bimë-tokë për marrjen e prodhimeve konstante vjetore.

- Zgjatet jeta e hardhisë

- Eleminohen pjesët e sëmura, të thata e gjithçka e tepërt ose e dëmshme.

- Favorizon qarkullimin e ajrit, depërtimin e dritës e ngrohtësisë.

- Lehtëson luftimin e sëmundjeve e dëmtuesve dhe shërbimet agroteknike.

- Garantohe cilësia e prodhimit.

- Si përfundim: Realizohet ekuilibri i domosdoshëm biologjik midis pjesës ajrore dhe asaj nëntokësore të bimës, i cili kompletet dhe mbyllet përfundimisht me operacionet e gjelbëra (krasitja verore) si vazhdim i krasitjes dimërore.

Pse krasitja është një e keqe e domosdoshme?

E keqe: Sepse prish raportet e vendosura gjatë vitit vegetativ midis bimës dhe tokës.

E domosdoshme: Për të gjitha arsyet e renditura më sipër

Llojet e krasitjes

Nga pikpamja e moshës ndahen: - Krasitje formuese - Krasitje prodhuese - Krasitje ripërtëritëse

TEKNIKAT E KRASITJES DIMËRORE TË HARDHISË

Krasitje të veçanta (nga ngrica, breshëri, kanceri etj.)

Qëllimi i krasitjes formuese: Krijimi i një trupi të drejtë mbi të cilin shpërndahen elementët e prodhimit në vitet që pasojnë.

Teknika e kryerjes: Në vitin e parë pas mbjelljes (janar të vitit pasardhës të mbjelljes) paraqiten disa raste nga pikpamja e fuqisë së bimës:


1- Kur 1 ose 2 lastarë të çelur, gjatë vegetacionit, kanë patur zhvillim të dobët duke arritur gjatësinë e pjesës së pjekur jo me shumë se 30-40 cm dhe trahësi 3-4 mm. Në këtë rast krasitja bëhet duke lënë vetëm 1 lastar me 2-3 sytha të pjekur e të pa dëmtuar.

2- Kur lastari ka gjatësinë të konsiderueshme deri në 1m, por mjaft i hollë (4-5mm) Edhe në këtë rast krasitja bëhet duke lënë vetëm 2 sytha (lënia e një lastari të gjatë, por të dobët, do të krijonte mundësinë e një zhvillimi të madh gjatë vegetacionit të 1-2 lastarëve të bazës, duke mos shfrytëzuar dot vitin e dytë, gjatësinë e arritur vitin e parë).

3- Kur lastari në fund të vegetacionit të vitit të parë ka arritur gjatësinë e pjesës së pjekur mbi 1m dhe trashësinë mesatare rreth 9 – 10 mm: në këtë rast krasitja bëhet duke lënë në qysh vitin e parë lastarin e zhvilluar (që do të jetë trungu i ardhshëm i bimës) në gjatësinë e shtrirjes së telit bazë plus 3-5 sytha (që do të jenë fillësia e kordonit bazë).

Lënia e më shumë sythave, në këtë rast, do të sillte për shkak të fenomenit të polaritetit në hardhi, mosçelje të sythave të bazës, e si pasojë problem të formimit të një kordonit teknikisht të rregullt. Sythat nën lartësinë e telit bazë qorohen të gjithë gjatë procesit të krasitjes. 4- E rëndësishme është që për formimin e një trungu të drejtë e pa deformime, qysh vitin e parë të


vendosen hunj mbështetës, pas të cilit do të lidhet, gjatë vegetacionit, lastari më i zhvilluar.



Në vitin e dytë Në rastin kur nga viti i parë kemi lënë një lastar të gjatë, mbi lartësinë e telit, (rasti 3) gjatë vegetacionit, hiqen të gjithë lastarët e dalë poshtë lartësisë së telit bazë, ndërsa lastari i parë i çelur në sythin e parë të kordonit shtrihet për të formuar krahun tjetër të kordonit, në rastin e kordonit bilateral. Në krasitjen dimërore punohet sipas formës së mbajtjes së përcaktuar në projekt, për krijimin e elementeve prodhues, por gjithmonë me një ngarkesë racionale, për të realizuar vitin pasardhës një çelje të plotë dhe uniforme të sythave, lastarët e të cilëve do të jenë baza e formimit të elementëve të viteve pasardhës.

Në rastin kur nga viti i kaluar, kemi lënë në krasitje dimërore 1 lastar me 2-3 sytha, nga lastarët e çelur, atë më të fuqishmin e lë më udhëheqes, duke e lidhur disa herë pas kunjit për të formuar një trunq të drejtë, ndërkohë që 1-2 lastarët e tjerë më pak të zhvilluar i pincojmë për të shërbyer

gjatë vegetacionit si organe ushqyes të bimës. Vitin e tretë këta lastarë largohen plotësisht



nëpërmjet krasitjes dimërore. Në vitin e tretë: Kemi krijuar të dy krahët e kordonit, në rastin e kordonit bilateral, ose kordonin e plotë (deri në distancën, në kufirin me bimën fqinje), në rastin e kordonit të njëanshëm. Në lastarët që kanë shpërthyer gjatë vegetacionit mbi krahët e kordonit, lihen në çdo 20-25 cm, çepa me 2 sytha, në lastarët e të cilëve vitin e katërt e më pas, realizohen format e dëshiruara të krasitjes. Është për t'u theksuar fakti që në bimë të ndryshme të të njëjtit vreshtë, (mbi bazë n e zhvillimit individual të çdo bime) kryhen krasitje të ndryshme me karakter formimi në të njëjtin vit, në përshtatje me vetë bimën.

Krasitja prodhuese

- Qëllimi: Krijimi i ekuilibrit të drejtë vegetativo-produktiv. Realizohet nëpërmjet 3 sistemeve të krasitjes prodhuese: - Sistem i krasitjes së shkurtër, (Të dy elementët, si të zëvendësimit dhe të prodhimit, përfaqësohen nga lastarë me

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

(Vijon nga faja 11)

2-3 sytha), (format më të njohura e të përdorura: Kordon roaja dhe forma Kupore).

- Sistemi i krasitjes së gjatë, Në bimë ndodhen



vetëm lastarë me jo më pak se 7-8 e më shumë sytha, pa praninë e çepave me 2-3 sytha. Format më të njohura e më të përdorura: (Sylvoz dhe Kazarsa e një dhe dyanëshme, etj).

- Sistemi i krasitjes së përzjerë: Kombinim i të dy sistemeve (ndeshen element të çepave me 2-3 sytha, si dhe elemente prodhimi me sharmenda me 7-8-12-16 sytha, në vartësi të faktorëve të tjerë. Format më të njohura: Gyjo (mono dhe dopio), Kaznav, Kurriz peshku, etj.



TEKNIKAT E KRASITJES DIMËRORE TË HARDHISË

Nga se varet zgjedhja e një sistemi apo forme krasitje?

1. Terreni:

a. malor, pjerrësi e madhe të terrenit, ose taraca me sheshe të ngushtë, këshillohet:

forma kupore, ose mono gyjo, në vartësi të kultivarit.

b. Kodrinor, me pjerrësi mesatare, këshillohet: Forma Kordon Roaja, mono ose dopjo Gyjo, në vartësi si të kultivarit.

c. Fushor:

Kultivim me tenda industriale, me kultivarë tavoline ose për tharje, ose forma "Kaznav", "Kazarsa e modifikuar", etj.

2. Pjelloria natyrale dhe plehërimi:

• Në toka të pasura ose me mundësi plehërimi ushqyes, preferohen Forma të larta kultivimi, me ngarkesë maksimale, të kultivarë ve të tryezë s dhe me më pak ngarkesë në kultivarë t industrialë duke patur si kusht kryesor cilësinë dhe destinacionin e prodhimit. Tendencat e sotme: Rritja e cilësisë së prodhimit nëpërmjet uljes së ngarkesës me sytha dhe kompensimi i prodhimit të planifikuar me rritjen e numrit të bimëve për ha.

3. Distanca e mbjelljes dhe numri i bimëve për ha:

- Në distanca mbjellje të mëdha këshillohet sistem i përzjerë i krasitjes dhe

- Në distanca të vogla: sistem i shkurtër me elementë të reduktur të sistemit të gjatë.

4. Kultivari, Rëndësi në zgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm të krasitjes ka Kultivari, lidhur kjo me aftësinë prodhuese të sythave në gjatësi të sharmendës.

5. Sipas destinacionit të prodhimit,
- Kultivarët që preferojnë formë krasitje të shkurtër (2-4sytha), janë:

• Kultivarë tryeze

- Moskat Hamburg (Prodh.mirë, Kr.sh. m.) - Alfons Lavale (Prodh.mirë, Kr.sh. m.gj.) - Kardinal (Prodh.mirë, Kr. m.)
- Moskat Aleksandrie (Zibibbo) - Moskat D'adda

(shkurtër – mesatare).

- Shaslla dore' (Jug.shku-Veri.gjat)

• Kultivarë për përpunim:

- Sheshi i Zi (Sh.mirë, vere kuqe, kr.shkurt)
- Shardone (V.kuqe, kr.shkurt)
- Vlosh (Sh.mirë, ver.kuqe, kr.shk)
- Karignjan
- Merlot (pr,mirë,ver.kuqe, (3 sytha)
- Prodhonjësit direkt (hibridet).
- Sangjenoveze (kr,shk.-mes. ver.kuqe).
- Montepulciano (kr,shk.-mes. ver.kuqe).
- Kabinet Sovignon (kr,shk.-mes. ver.kuqe).
- Negro amaro (Kr. #, v.kuqe)
- Kallmet (mirë- Sh.mirë, vere kuqe, kr.shkurt)
- Trebiano Romanjolo (Kr.Sh-mes, v.bardh)
- Reisling Italian (V.bardhe)
- Sheshi i Bardhë (Sh.mirë, vere e bardhe, kr.sh)

• Preferojnë krasitje me sharmend, me gjatësi mesatare (6-8 sytha e deri në të gjatë 10-12 sytha, Kultivarët:

- Regina dei vignjetti (Rr.tryeze) - Perla ksaba
- Barbera (ver.kuqe,) - Malvasia (ver.bardh,)
- Perleta (Rr.tryeze) - Panse Prekoçe - Hibridi V-6
- Alfons Lavale (Rr.tryeze) - Lambrusco maestri (ver.kuqe,) - Viktoria (Rr.Tryeze) - Diamante (Rr. tryeze) - Matilda (Rr.tryeze) - Mikele Palieri (Rr. tryeze) - Perlona (Rr,tryeze)

• Krasitje të gjatë-shumë të gjatë deri në shumë të gjatë (10-16 sytha):

Rrush tryeze:

a - Kultivarët me farë:

- Italia (Rrush tryeze) - Afuzali Rexhina Bianka (tryeze) - Tajkat (tryeze) - Alfons Lavale (tryeze)
- Regina dei vignjetti (Rr.tryeze) - Shardone (Rr. tryeze, i kuq, kr.gjat)

b - Kultivarët pa farë:




.. Sulltanina e bardhë (tryeze-tharje) .. Sulltanina rozë (tryeze-tharje) .. Taif rozë (tryeze-tharje) .. Sublima Sedles (tryeze-tharje).

• Varietet e vendit si Kallmeti, Sheshi i zi, Sheshi i bardhë duhet të mbillen në vreshtat e

reja, sepse vlera e tyre ekologjike dhe prodhimi që ato japin, janë të larta e cilësore. Aplikimi i çdo lloj krasitje jep rezultatet e dëshiruara kur shoqërohet me kompleksin tërësor të masave agroteknike. Krasitja jep vetëm mundësinë e shfrytëzimit maksimal të potencialit prodhues të sejcilit kultivar.

• Koha e krasitjes: Për zonën e ulët bregdetare të vendit: Fundi i Dhjetorit - 10 Shkurt. Për zonën e ftohtë: 20 Shkurt - 10 Mars.

• Format e krasitjes:
- Forma Kupore e krasitjes:
- Forma Kordon Roaja e krasitjes:
- Forma Gyjo (dopio) e krasitjes:



Këshilla praktike

- Plaga të qëndrojnë nga sipër pjesës që mbetet.
- Prerje të rafshita
- Pjesa e butë e gërsërës në pjesën që mbetet
- Prerje të tërthorta dhe jo vertikale
- Krasitje jo në kohë me shi
- Dizinfektimi i plagëve të rënda pas krasitjes
- Ndhimesa në krasitje me dorën e majtë

Përgatiti: Llambro Dhima, Përgj.Sekt.Transf.Tekn. Bujq.

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Për fermat e dhenëve

Fermerë: Jemi në fushatën e pjelljes së deleve. Ezaurimi me sukses i kësaj fushate është garanci për rritjen e prodhimeve blegtorale, pra rritjen e të ardhurave të fermës suaj.

Për trajtimin korrekt ushqimor dhe shërbimin gjatë pjelljes ndani tufën në tre grupe (sipas mundësive konkrete):

- Dele të pjella (grupi i tekeve dhe i dyjareve)
- Dele gati për të pjellë
- Dele që pjellin në sezon të mëvonshëm.

- Sipërfaqe më e madhe për krerë duhet të sigurohet për delet e pjella dhe gati për të pjellë. Kjo ndarje ju lehtëson trajtimin dhe të ushqyerin e diferencuar të tyre.

- Zbatoni racionet ushqimore sipas grupeve me normat e rekomanduara në rubrikat e mëparshme.

- Kontrolloni ushqimet para përdorimit. Ushqimet e mykura, të ngira etj janë shkak për dështimet, dëmtimet e kafshëve dhe si rrjedhojë për

KËSHILLA PËR FERMERËT QË MBARËSHTOJNË BAGËTI TË IMTA

humbjet ekonomike.

- Siguroni kushte optimale mbarështimi gjatë fushatës së pjelljes (temperatura ambientale; 20-22o C), shtresë të bollshme me kashtë, evitoni lagështinë dhe amonjakun në stalla (të mos djegin sytë kur hyni në mëngjes në stallë), siguroni ajrim, ndriçim, përdorni për dezinfektim pluhur gëlqereje ose superfosfat 100 gr/m2 një herë në 10 ditë etj.

- Asistoni çdo dele në pjellje, dezinfektioni këthizën (kordonin umbelikal të qengjit) me tinkturë Jodi 3 %, domosdoshmëri për të parandaluar infeksionet e ndryshme të organeve të brendshme dhe kryesisht in-

feksionet banale të mëlcisë. Përdorni doreza plastike gjatë ndërhyrjeve për tu mbrojtur nga infeksionet.

- Ndhmoni qengjat e porsalindur që të pijnë kulloshtrën gjatë orës së parë të paslindjes, garanci kjo për rritje të shëndetshme të tyre (kulloshtra në orën e parë të jetës së kafshës është një ushqim i pazëvendësueshëm).

- Për delet që nuk pranojnë qengjat krijoni bokse individuale për t'u lidhur deri në momentin që ato (delet) të pranojnë pjellat e tyre.

- Hiqni menjëherë placentën (shtratin) dhe qengjat e dështuar, dezinfektimi vendin ku pjell ose dështon

delja dhe groposini ato në gropa septike të caktuara nga ana juaj paraprakisht.

- Delet e dështuara duhet të ndahen me vehte dhe duhen mjekuar nëse kanë probleme të aparatit riprodhues.

- Pastroni gjirin nga leshi (përvjelje) menjëherë mbas pjelljes me qëllim që qengji të pijë në gji të pastër.

- Përdorni ujë të pastër dhe jo të ngrirë për të gjitha kafshët.

- Në zonat ku çfaqet sëmundja e mishit të bardhë (me paraliza në qengja), të bëhet trajtimi paraprak i tyre një javë pas pjelljes me Vit E + Selen, ose në delet barsa si profilaksi në periudhën e fundit të barsmërisë (Vitamina E dhe seleniti i natriumit kalojnë barrierën placentare; këshillohu me veterinerin).

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

Për sqarime të tjera kontaktoni:
Sotiraq Jankulla cel: 0682630700
E-mail: sotiraqjankulla@yahoo.com

KËNDI I EKSPERTIT

Domatet më të shijshme në Botë

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Domatja si perime më e njohur dhe më e rëndësishme në Botë kultivohet dhe konsumohet kryesisht për shijen e saj dhe për vlerat e saj ushqimore.

Një nga kënaqësitë e thjeshta të jetës është një fetë e lëngshme e domateve të pjekura në kopshtin e shtëpisë, me shije të ëmbla dhe të tharta që përzihen në mënyrë magjike në gjuhë.

Shija e domates është një ekuilibër i acidit dhe sheqerit i njohur nga gjuha dhe efekti i përbërjeve të paqëndrueshme brenda frutave që shkaktojnë aromë të njohur nga hunda. E thënë thjesht, perceptimi i njeriut për shijen e domates përfshin integrimin e shijes dhe aromës.

Domatet me shije më të mirë janë ato që mblidhen direkt nga bima dhe hahen në kopsht ndërsa janë ende të

në përqëndrimin e sheqerit të frutave dhe zhvillimin e substancave të paqëndrueshme.

Një domate me përmbajtje të lartë në sheqerna dhe e ulët në acide ka një shije të ëmbël. Një domate me përmbajtje të ulët në sheqerna dhe acide ka një shije të butë. Shija tradicionale e domates - e preferuar nga shumica e njerëzve - është një kombinim gati 50 % -50 % sheqernash dhe acidesh; kjo shpesh quhet aromë domate "e modës së vjetër".

Një domate është në fakt një kombinim kompleks i shijeve që stimulojnë gjuhën në 3 fusha kryesore: e ëmbël, e thartë

domateve, por si zakonisht, ka dhe përjashtime. Domatet e verdha dhe të bardha janë përgjithësisht delikate në shije dhe kanë pak acid. Domatet e kuqe të errëta mund të kenë një shije intensive të ekuilibruar. Shumë domate jeshile janë të tharta (madje edhe të shijshme).

Por, nuk ka asgjë që mund të krahasohet me shijen e një domateje të freskët, të pjekur në bimë, e këputur në kulmin e përsosur të ëmbëlsisë dhe e ngrënë e ngrohtë dhe e sheqerosur, e thartë dhe e lëngshme, pikërisht atje në kopsht.

Ka një gamë të gjerë dhe të thellë shije të disponueshme në kultivarët e domates dhe vlerësimi i tyre varet nga vendi, tradita dhe shijet personale të secilit.

Domatet e kuqe dhe rozë zakonisht kanë përmbajtje më të lartë sheqeri se përqëndrimet e acidit. Domatet portokalli, të verdha dhe të bardha janë më pak acide se domatet e kuqe dhe po kështu kanë shije të butë ose kombinimi i niveleve të sheqerit dhe acidit dhe përbërjeve të paqëndrueshme kanë efektin e një shije më të butë.

Domatet e zeza dhe të purpura - të krijuara nga një përzierje pigmentesh jeshile dhe të kuqe - njihen për aromën e tyre komplekse - megjithëse nivelet e acidit dhe sheqerit mund të jenë pothuajse të balancuara.

Domatet qershiza dhe rrush - të cilat mund të ndryshojnë në ngjyrë - kanë përqëndrime të larta të sheqerit dhe shije më të ëmbël se domatet me madhësi të plotë.

1. Domate jeshile gjermane e tezes Ruby

Aunt Ruby's German Green është një domate e madhe, e verdhë-jeshile me një shije të ekuilibruar të ëmbël dhe të thartë. Domatja e Gjelbër Gjermane e Aunt Ruby është ndër varietetet më të vlerësuara të domates së gjelbër për shkak të shijes së saj intensive. Ka një pasuri dhe pak erëz që janë të papritura nga pamja e saj. Kjo shumëllojshmëri zgjidhet dhe shijohet më së miri përpara se të piqet tepër ose para se të arrijë moti i ftohtë i vjeshtës.

Aunt Ruby's German Green është një kultivar i madh domatesh i llojit të bifteku. Forma e frutave individuale është e parregullt, e rrafshuar (e shtypur në polet dhe e lobuar mirë). Domatet fillojnë me ngjyrë jeshile, por marrin pak të verdhë dhe ndonjëherë edhe pak rozë kur piqen.

Domatja e Gjelbër Gjermane e Tezes Ruby është emëruar për Ruby Arnold nga Greenville, Tennessee, e cila e rriti këtë varietet pasi gjyshi i saj ia dorëzoi familjes. Një nga biftekët më të mëdhenj të



gjelbër. Mund të rritet deri në 0.5 kg dhe është e shijshme. Ka një tul të shkëlqyeshëm, neon-jeshile me një aromë të fortë, të ëmbël dhe frutash, shumë më të shijshme se shumica e domateve të kuqe. Kjo trashëgimi familjare nga Gjermania është e bukur. Fituesi i testit të shijes së Heirloom Garden Show 2003.

2. Domate e zezë e Krimesë

Domatja e zezë e Krimesë (e njohur gjithashtu si Krimea e Zezë dhe Noire de Crimée) është një domate trashëgimie me origjinë nga Krimea. Bima është me pjalmim të hapur,

një nuancë të kuqe-jeshile të errët - por në përgjithësi janë mjaft të errëta dhe me pamje të tymosur në krahasim me trashëgimitë e tjera. Ata priren të errësohen me më shumë diell. Domatja Black Krim është një trashëgimi e Evropës Lindore e emërtuar nga rajoni i Krimesë dhe Detit të Zi që e rrethon atë.

3. Domatja Brandywine

është një kultivar i vjetër e domates, me gjethe të mëdha si gjethe patate, të lëmuara, ovale, me majë vend të gjetheve me lobe të dhëmbëzuara të shumicës së domatevedhe fruta të mëdha



e tipit të papërcaktuar (indeterminante), me fruta globi të rrafshuar deri 250 gram që janë me ngjyrë të errët të kuqërremtë-vjollcë në të zezë me shpatulla jeshile/kafe. Në vitin 1990, ajo u bë domatja e parë "e zezë" e disponueshme komerciale në Shtetet e Bashkuara.

Black Krim është një domate e madhe, e kuqe-jeshile e errët me një shije të spikatur dhe të ekuilibruar.

Shija e domateve Black Krim është e pasur, e spikatur dhe e plotë. Ka një shije të ëmbël, të balancuar me një sasi të përshtatshme aciditeti. Shija është komplekse, me një nuancë tymosjeje. Ëmbëlsia rritet kur lihet të piqet plotësisht në bimë.

Domatet Black Krim janë domate të mëdha, të stilit të bifteku. Frutat në përgjithësi kanë një ngjyrë të kuqe-vjollcë të errët ose ngjyrë kafe. Ato gjithashtu mund të kenë

rozë në formë bifteku. Konsiderohet gjerësisht ndër shijet më të mira në dispozicion.

Fruti i saj i madh me ngjyrë rozë në formë bifteku mund të rritet deri në 0.7 kg dhe është përshkruar se ka një "aromë të shkëlqyer domateje", e kompensuar nga një aciditet tërheqës. Ka një formë domateje bifteku, lëvore dhe tul të përzier të kuq dhe vjollcë të thellë dhe mund të ketë shpatulla jeshile pranë kërcellit edhe kur është plotësisht i pjekur.

Bima kultivohet shumë, pavarësisht se fruti kërkon 80 deri në 100 ditë për të aritur pjekurinë, duke e bërë atë ndër varietetet më të ngadalta të maturimit të domates së zakonshme dhe rendimentin relativisht të ulët të kultivarit.

Origjina e kultivarit Brandywine kompen mbetet e paqartë. Kompania Burpee Seed raporton se e mban atë në katalogun e tyre që në vitin 1886, dhe ka referenca për të më të vjetra se

kaq. Edhe pse shpesh thuhet se është me origjinë Amish, nuk ka asnjë provë që e mbështet këtë.

4. Domatja Cherokee Purple

me origjinë nga Tenesi, mendohet se janë transmetuar nga amerikanët vendas të fisit Cherokee. Cherokee Purple është një domate e madhe, e purpurt me një aromë intensive që është ekuilibri i përsosur midis ëmbëlsirës dhe thartësisë. Shija e domateve Cherokee Purple ka një ekuilibër kompleks të ëmbëlsisë dhe shijes. Ka aromën e plotë klasike të një domateje të mirë trashëgimie. Domatet Cherokee Purple janë të mëdha, të ëmbla dhe me lëng. Shija e kësaj domate është ndër më të vlerësuara nga ata që vlerësojnë shijen e pasur të domates.

"Cherokee Purple përcakton kryqëzimin ideal të ëmbëlsisë, thellësisë dhe strukturës."

Domatet Cherokee Purple janë përgjithësisht mjaft të mëdha dhe mund të mendohen si një lloj bifteku. Ngjyra e tyre është një vjollcë e shkallëzuar me nuanca të gjelbra. Pjesët më të zbehta të domates janë një ngjyrë trëndafil i errët. Ndonjëherë ato duken si një domate e kuqe me vija jeshile. Ata nuk janë një vjollcë e vërtetë e errët si Black Krim. Domatet Cherokee Purple rriten në të gjitha format dhe



madhësitë, nga mjaft të rumbullakëta deri te ato me pulla jo të përsosura. Nuk është e pazakontë që çdo domate të peshojë deri 400 gram.

Cherokee Purple është një kultivar domatesh i trashëguar i rritur dhe i transmetuar nga popujt indigjenë në Tenesi. Bimët e domates Cherokee Purple janë bimët mëdha, të papërcaktuara (Indeterminante) që mund të rriten mjaft të larta. Këto bimë mund të kenë nevojë për një sistem të fortë mbështetës për të mbajtur frutat e shijshme larg tokës.

Domatet Cherokee Purple për ngjyrëne pasur, të errët dhe shije të pasqorë të ëmbël dhe të pasur përdoren në sanduiçe ose në sallata. Domatja është një rozë e bukur e errët me një brendshme të thellë, të kuqe të pasur. Mund të vjelim mesatarisht 20 ose më shumë fruta nga çdo bimë.

(Vijon në numrin e ardhshëm)



ngrohta nga dielli. Nuk ka asgjë të ngjashme me shijen e një domateje të rritur në shtëpi. Ato janë përzierja perfekte e natyrës e ëmbëlsisë dhe thartësisë.

Shija e domates zakonisht përshkruhet si e ëmbël, e thartë, e mprehtë ose e ekuilibruar. Shija e domates ndonjëherë përshkruhet edhe si "aromë klasike e domates" ose "aromë domate e modës së vjetër". Dhe aroma e disa domateve përshkruhet si e butë ose e lehtë. Sheqernat në domate - kryesisht fruktoza dhe glukozoza - rezultojnë në një shije të ëmbël. Acidet në një domate - kryesisht acidet citrik dhe malik - rezultojnë në një shije të thartë, ndonjëherë të athët. Komponimet e paqëndrueshme ose vajrat në fruta,

të cilat lëshohen si aromë kur frutat shtypen gjatë ngrënies, kontribuojnë në aromën. Aroma është e integruar me shijen për të krijuar shije të plotë. Ekzistojnë 15 deri në 20 përbërës të paqëndrueshëm të sigurt në një domate. (Një domate mund të ketë më shumë se 400 komponime të paqëndrueshme).

Sasia e sheqernave, acideve dhe komponimeve të paqëndrueshme në një domate mund të ndryshojë sipas shumëllojshmërisë dhe kryesisht përcaktohen gjenetikut. Megjithatë, faktorët mjedisorë - sasia e dritës së diellit, lëndëve ushqyese dhe uji që merr një bimë gjatë zhvillimit të frutave - mund të ndikojnë

dhe e shijshme. Një domate e mirë duhet të ketë të tre cilësitë tëshijes: Acid, si një mollë. E ëmbël, si një luleshtrydhe dhe Lëng, si një kumbull.

Domatet me shije më të mirë shpesh kanë një shije të vërtetë të modës së vjetër me një ekuilibër të shkëlqyer të sheqerit dhe aciditetit.

Ka disa gjëra të përgjithshme për t'u kërkuar kur kërkon domatet më të shijshme. Domatet me shije më të mirë tregtohen si "të prera" ose të mira për "ngrënie të freskët". Ato shpesh reklamohen si të mira në sallata ose të freskëta në sanduiçe. Këto domate janë edukuar për shije në vend të karakteristikave të tjera (si të jenë të mira për konservim ose përgatitje të salcave të gatuar).

Domatet me shije më të mirë në përgjithësi kanë një ekuilibër plotësues të aciditetit dhe sheqerit. Një domate e freskët do të lëshojë gjithashtu komponime organike që përmirësojnë shijen e saj dhe na sjellin aromën e "domates së freskët kopshti".

Disa domate janë shumë të ëmbla, ndërsa të tjerat janë thjesht të tharta. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me gjenetikën e shumëllojshmërisë së domates, por edhe me motin, kushtet e tokës, pjekurinë e domates dhe faktorë të tjerë mjedisorë. Në përgjithësi, këto bimë rriten më mirë me shumë rrezet e diellit, pak plehra dhe ujtitje të mirë. Ka disa modele në shijet e

BUJQËSIA NË VITIN 2023

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca: 2022-shi një vit nga më sfiduesit për bujqësinë. Mbështetëm mbi 49 mijë fermerë në uljen e kostove të prodhimit, duke ofruar buxhetin më të madh të vënë në dispozicion të subvencionit 9 masa financimi. Blegtoria prioritet i bujqësisë, rrisim mbështetjen për fermerët, agropërpunuesit, peshkatarët dhe gjithë komunitetin rural

(Vijon nga faqja 3)

operatorët të klasifikuar me risk më të ulët, të cilët do të kenë një frekuencë kontrolli të ulët.

Në vitin 2022, janë kryer mbi 32 mijë kontrolle zyrtare. Këto kontrolle jo vetëm kanë qënë 7% më tepër, por kanë dhënë rezultate ka 74% e rasteve kanë qënë në konform të plotë me kërkesat ligjore, (me një përmirësim 3% më shumë se 2021) dhe ndërkohë 26% të tjera, kanë patur problematika të ndryshme, për të cilat sipas rasteve AKU ka vepruar nga këshillimi deri në pezullimin e aktivitetit deri në plotësimin e kërkesave ligjore.

Nga viti tjetër fillojmë pilotimin e e-inspektive me të paktën 100 subjekte, duke mundësuar që të kontrollohen për përputhshmërinë e tyre online, pa patur nevojë të vizitimit në terren të inspektorëve të AKU.

Në vitin 2022, kemi lthyer 520 ton produkte nga importi, që nuk ishin në përputhje me kërkesat ligjore për importet. (93% më shumë se një vit më parë).

Kemi pasur kontrolle të dedikuara ndaj farmacive bujqësore pasi duam rreptësisht të ndalojmë tregtimin e produkteve të pamiratuara nga ministria për përdorimin në fermë. Kontrolle të dedikuara për mishin e pulës, vezës si dhe vajit të ullirit për të garantuar vërtetësinë e etiketës, respektimin e standardeve ushqimore në përputhje me ligjet në fuqi.

Me fushatat tona të ndërgjegjësimit me Ministrinë e Arsimit, kemi arritur që në vitin 2022 të kemi 960 ambasadorë të vegjël të sigurisë ushqimore. Do të vijojmë këtë iniciativë dhe përgjatë 2023, për të shtuar me të paktën 1000 ambasadorë të rinj të sigurisë ushqimore, si një 11 mënyrë e mirë për të ndërgjegjësuar konsumatorin.

NË VETERINARI

Puna e bërë gjatë këtij viti është gjithëpërfshirëse dhe ka një impakt të gjerë, që në të ardhmen e afërt do të ndihet edhe më tepër se sa sot. Në vitin 2022 me krijimin e strukturës në nivel qendror si Drejtori e e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit kemi siguruar ndërtimin e zinxhirit të komandës, duke qënë në linjë me të gjithë sektorët që përfshihen në kapitullin 12 të BE-së.



Kemi përmbyllur reformën e shërbimit të veterinarisë, duke pasuruar flotën tonë në terren me rreth 500 veterinerë, të cilët kanë akses të drejtpërdrejtë në ferma blegtorale, komunikojmë me familjet fermere dhe realizojnë matrikulimin, vaksinimin dhe gjurmimin.

Kafshët sot identifikohen me matrikuj pa pagesë, nga veterinerët e shërbimit zyrtar. Me anë të identifikimit mund të bëhet me lehtësi kontrolli i shëndetit të kafshëve, lëvizja, certifikimi, epidemiologjia dhe stabilimentet.

Sistemi i identifikimit dhe regjistrimit (IR) të kafshëve synon garantimin e një kontrolli më të mirë të shëndetit të kafshëve që nga lindja, lëvizja, therja dhe ngordhja e tyre. Gjithashtu siguron gjurmueshmërinë e kafshëve dhe fermave blegtorale, tregtinë, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive si dhe marjen e masave profilaktike.

Për të parandaluar dhe kontrolluar sëmundjet infektive realizohet vaksinimi kundër sëmundjes të Brucelozës në të imta, vaksinimi kundër Plasjes tek vatrat e vjetra për tre vite rresht, apo edhe tek vatrat e reja. Për të zbuluar sëmundjet si Brucelozë apo Tuberkulozi realizohet 12 gjurmimi në fermat e gjedhit dhe duke filluar nga viti 2022, e kemi shtrirë kontrollin në ferma me 5 krere e sipër, proces i cili më parë bëhej në fermat mbi 10 krere. Kështu në vitin 2022 janë kryer mbi 273 mijë vaksinime, +562 mijë matrikullime, rreth 115 mijë gjurmime për sëmundje të ndryshme, instalim i shërbimit veterinar në thertore të licensuara dhe tregje të licensuara kafshësh.

Kështu kemi mundësuar të paktën vizitimin e 92% të fermave blegtorale të paktën 1 herë në vit nga veterinerët tanë.

Me kalimin e kontrollit të thertoreve dhe tregjeve nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, kontrolli i therjeve dhe certifikimi i mishit bëhet nga Shërbimi Veterinar i Drejtorisë Rajonale dhe Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve duke krijuar mundësinë e MONITORIMIT LINEAR të procesit nga ferma deri në pikat e tregëtimit të mishit në bashkëpunim me AKU dhe duke siguruar kështu një produkt të sigurt për konsumatorin.

Në vitin 2022, rritja e therjeve në stabilimentet e licensuara ishte 32% më shumë se një vit më parë dhe ky trend rritës do të vijojë për vitin 2023.

Sot kemi 75 thertore dhe 6 tregje me shërbim veterinar të dedikuar. Ky është një lajm i mirë për ne, për qytetarët, por edhe për rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian dhe në zbatim të axhendës së përbashkët me ta.

NË MBROJTJEN E BIMËVE

Në kontekstin e përmirësimit të legjisllacionit dhe kuadrin rregullator, me ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen e Bimëve kemi siguruar tashmë, që në Shqipëri të tregtohen vetëm pesticide apo produkte të mbrojtjes së bimëve të regjistruara në Bashkimin Evropian, duke respektuar fazat tranzitore.

Kemi sjellë në jetë një plan 10-vjeçar të Veprimit për Përdorimin e Qëndrueshëm të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, kemi tashmë një dokument bazë që siguron qasje të sigurt dhe të qendrueshme për mbrojtjen e shëndetit

të bimëve, të sigurisë së prodhimit, dhe mbrojtje të shëndetit të njerëzve, me një ulje të impaktit negative në mjedis. Nga ky vit po zbatojmë Regjistrin e Fermerit si dokumenti ku çdo fermer do të regjistrojë PMB-të e përdorura, numri e data e spërkatjes, intervalet e sigurisë - koha e karencës para vjeljes për çdo kulturësi elemente absolutisht thelbësore për sigurinë ushqimore të produkteve bimore fundore, për sigurinë e shëndetit të fermerëve, të konsumatorit, për mbrojtjen e mjedisit si dhe rritjen e besueshmërisë së eksporteve shqiptare.

Parandalojmë dhe garantojmë kështu një produkt të sigurt pa mbetje rastësore pesticide. Ky dokument kryen edhe funksionin e anasjelltë.

Ai siguron gjurmueshmërinë në rastet e konstatimeve të produkteve me mbetje, ku ndiqen të gjitha hapat e përdorimit të pesticideve dhe korrigjohet një ndër problemet e trashëguara të përdorimit mbi masën e pesticideve.

Ndryshimet ligjore të bëra kanë përafuar në një mënyrë thelbësore legjisllacionin e sigurisë ushqimore me atë Evropian.

Janë kryer mbi 7.200 monitorime fitosanitare dhe inspektuar rreth 19 mijë eksporte dhe rieksperte.

Gjithashtu, kemi mundësuar certifikimin e më shumë se 43 milionë fidanëve dhe 1.540 ton fara.

CEFTA TRACES: Një risi pas një pune disa mujore për përgatitjen e të gjitha parakushteve për të qënë konkurreues me vendet e rajonit në 14 Korrik filloi projekt piloti CEFTA TRACES si një sistem ndërkombëtar për certifikimin fitosanitar të ngarkesave për eksport dhe riekspert. Jemi i pari vend nga vendet CEFTA, për numrin e certifikatave të lëshuara online, në SEED +, me të paktën 85% të tyre gjatë këtij pilotimi.

CEFTA TRACES i lejon sot eksportuesve shqiptarë të prodhojnë dhe shkëmbejnë dokumente shpejt dhe me efikasitet duke lehtësuar tregtinë e ngarkesave të fruta – perimeve dhe duke shkëmbyer në kohë reale të dhënat që përmban certifikata fitosanitare nëpërmjet autoriteteve fitosanitare brenda rajonit CEFTA.

Objektivat 2023 - Siguria Ushqimore

2023 është një vit shumë i rëndësishëm për kantierin e sigurisë ushqimore. Është viti i fillimit të procesit të screening, proces i cili krahas skanimit të akteve legjisllative do të shqyrtojë dhe vlerësojë me detaje në proceset e monitorimit, kontrollit, mostrimit, analizimit, raportimit dhe marrjen e masave të përshtatshme me synim kryesor sigurimin e shëndetit të konsumatorit shqiptar dhe atij Evropian për produktet e eksportit.

Kështu do të finalizojmë miratimin e Strategjisë për Sigurinë Ushqimore si një dokument politikash për të gjithë sektorin. Do të punojmë gjithashtu për hartimin e 3 projektligjeve të reja për sektorin "Për Shëndetin e Kafshëve", "Për shëndetin e bimëve" dhe "Për kontrollin 15 zyrtarë". Do të vijojmë gjurmimin nga ferma në tavolinë, dukë kontrolluar zbatimin e regjistrave të fermerit në fermë dhe e lidhur atë me pikat e grumbullimit duke ndërgjegjësuar. Në vitin 2023 kontrolli me Bazë risku i operatorëve të biznesit ushqimor do të jetë STANDARD për inspektimet e AKU-së – STANDARD.

Së fundmi, në vitin 2023 fillojmë dhe investimin e rreth 22 MLN EUR për fuqizimin dhe modernizimin e Laboratorëve lokalë të AKU, për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme në 6 pika të kalimit Kufitar dhe për fuqizimin dhe shtimin e kapaciteteve Laboratorike të ISUV.

5. ZHVILLIMI RURAL

Mbështetja për sektorin ka qënë e madhe në vitin 2022, një vit të referohemi gjithmonë për punën e bërë dhe financimin përmes Skemës Kombëtare, IPARD-it dhe mbështetjeve të tjera si Fondi i Garancisë.

Skema Kombëtare për vitin 2022 ka marrë financimin më të madh ndonjëherë, sepse Qeveria Shqiptare i është përgjigjur, në kohë dhe me instrumenta, krizës së shkaktuar nga agresioni Rus në Ukrainë për t'i ardhur në ndihmë fermerëve dhe nevojave të tregut.

Nga parashikimi fillestar prej 3.2 miliardë lekësh, Skema Kombëtare e mbështetjes se drejtpërdrejtë mori një buxhet përfundimtar prej 5.1 miliardë lekësh



për fermerët shqiptarë thajse sa buxheti i 5 viteve të fundit. Skema ka sjellë formalizim dhe rritje të aplikimeve. Nga 32 mijë aplikime në 2022 në 70 mijë aplikime në 2022. E rritëm buxhetin për të përballuar sa mundnim këtë kërkesë duke e ritur numrin e përfituesve si kurrë më parë në 48 mijë e 734 përfitues në vitin 2022.

Çfarë na kanë dhënë në vitin 2022 këto fonde të shpërndara për fermerët:

Kemi mbështetur - 852,108 krerë; 16, 666 ha - 308,270 koshere; 1 646 ha bimë medicinal; - 1267 përfitues me 200 milionë lekë për 228 ha të mbështetur për 17 kostot e prodhimit në fara, fidanë apo plehra kimike për prodhimet në serra duke orientuar bashkim në prodhimin në serra. Duke fuqizuar fermerin. Skema e Naftës arriti në 1.95 miliardë mbështetje për 34 731 fermerë përfitues.

Fondi është disbursuar në masën 100% dhe janë shpërndarë 8.4 milionë litra për:

• 126'779 ha kultura në total; 39 mijë ha misër; 22 mijë ha grurë; 23 mijë ha foragjere. Në vitin 2022, mbështetja nga programi IPARD II ka qënë gjithashtu i gjerë, ku kemi kontraktuar 19.4 milionë EUR, kemi disbursuar 19.5

milionë EUR me 226 kontrata në total dhe 111 kontrata të paguara.

Ky financim ka parë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në bujqësi me:

13 ferma blegtorale; 45 investime në turizëm rural; 63 investime në mekanikë bujqësore; 5 linja përpunimi dhe 33 magazina dhe pika grumbullimi; 35 investime në mbjellje të reja në kantina; 37 investime në serra dhe 12 investime në energji të rinovueshme

Këtë dua tja u tregoj sërish përmes një profili konkret suksesi, kësaj radhe në sektorin e blegtorisë të cilën mbështetja e ka ndihmuar për rritjen e prodhimit të qumështit. Kjo është Luçe Hasanaj nga Malësia e Madhe e cila ka gjithë jetën që merret me blegtori, një traditë familjare. Ajo ka përfutur mbështetjen prej Programit IPARD II për ndërtimin e stallës, sot ka një tufë me 200 dhi të racës franceze sana dhe alpine. Luçe është vetëm një nga këto raste që pasqyron përpjekjet tona për të maksimizojmë burimet e financimit dhe investimet në terren. Angazhimi për financimin e dhënë nga IPARD është një dëshmi shumë e mirë e punës që dimë të bëjmë mirë për bujqësinë. Detyra jonë është që mbështetjen nga IPARD dhe atë nga Skema Kombëtare ta orientojmë drejt avantazheve konkurruese të bujqësisë shqiptare.

Prandaj arritje e rëndësishme ishte ndërtimi dhe miratimi i Programit IPARD III për financimin e bujqësisë shqiptare me 146 milionë EUR ose 56% më shumë se në IPARD II. Injektojmë financimin më të madh në bujqësi.

Kemi marrë përsiper të akreditojmë masa të reja për më shumë mundësi financimi. Kemi arritje në përthithjen e Fondit të garancisë ku qeveria shqiptare dhe BERZH zbaton Programin e Mbështetjes së Agrobiznesit dhe Turizmit Shqiptar prej vitit 2016. Fondi total është 180 Milionë dhe deri në fund të tremujorit të vitit 2022 janë disbursuar 90 milionë EUR, nga të cilat 20 milionë EUR vetëm gjatë vitit 2022, ose 22% e totalit të financimit në 6 vite.

SKEMA KOMBËTARE E TRAJNIMIT NË BUJQËSI

Një nismë e rëndësishme për 2022 ka qënë Skema Kombëtare të Trajnimit me Universitetin Bujqësor të Tiranës, në përgjigje të nevojave të vazhdueshme me fermerë, agropërpunues për përmirësimin e mbështetjes në njohjen e teknikave të reja të prodhimit, zhvillimet e tregjeve të cilat do t'i mundësonin të korra më të mbara dhe të ardhura më të larta.

Arritje është trajnimi i 573 këshilluesve dhe specialistë të bujqësisë dhe 19 2000 fermerëve të cilët u trajnuan për herë të parë në bazë të nevojave të tyre, të kulturave bujqësore apo sistemeve të prodhimit që ato përdorin për: Shëndetin e bimëve; Teknikat e kultivimit në fushë dhe serrë perimesh, drufrutorë, Bimë aromatike etj.; Teknologjitë e ruajtjes së produkteve pas vjeljes; ato të mbarëshimit të blegtorisë; Teknologjitë e përpunimit të produkteve blegtorale etj.

Nismë e rëndësishme është investimi në tregje dhe agregatorë me bashkitë ku aktualisht nuk ka treg për prodhimet bujqësore duke synuar rritjen e aftësisë negociuese të fermerëve përballë tregtarëve. Në 2022 mbështetëm 5 tregje bujqësore me Bashkitë në Belsh, Bulqizë, Korçë, Tiranë dhe Zadrinë, ku janë 26 mijë përfitues të drejtpërdrejtë nga lehtësirat, që këto tregje do të ofrojnë, duke filluar nga Marsi i këtij viti tashmë.

Këto tregje do të jenë ura të tregëtimit të produkteve nga zonat më rurale. Së bashku me konceptin e agroturizmit, të fermat të diversifikuara dhe të skemave të cilësisë do të jenë katalizatorë të mirë të zhvillimit rural.

AGROTURIZMI

Agroturizmat ishin shumë të paktë, vetëm para 7 viteve. Sot jo vetëm kemi mbi 280 sipërmarrje në sektorin e agroturizmit (2022), por i kemi ofruar edhe një qasje lehtësuese në kuadrin fiskal. 46 janë njësitë agroturistike, që janë certifikuar dhe mbi 75 të mbështetur përmes skemave tona të mbështetjes. Sektori ka ecur shumë mirë, pasi ka një rritje të konsiderueshme të numrit të vizitorëve në fermat agroturistike në më shumë se 1000 në javë.

Sektori punëson më shumë 2500 individë, dhe në periudhën e verës zonat ruale punësojnë në mikpritjen, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të tyre më shumë se sa 2 fishin. 1 fermë agroturistike krijon efekte pozitive në rritje të shitjeve, rritjen e nivelit të punësimit, rritjen dhe stabilizimin e të ardhurave për së paku 20 familje fermere, ndërkohë fermat e mëdha agroturistike janë burim të ardhurash për qindra fermerë në zonat rurale. Më shumë se 70% e produkteve që ofrohen në agroturizëm janë produkt i njësisë prodhuese ose të përpunuar nga familja fermere.

Në e financim agroturizmin si vlerë të shtuar të bujqësisë, si magnet tërheqës për të rinjtë, si rrjetëzim financimi në zonat e thella rurale POR ne e shohim absolutisht si një nga platformat që po nxit më tepër lidhjen me tokën dhe me origjinën e produkteve.

Një shembull konkret i vlerave të agroturizmit është Gezim Hysa, përfutur i IPARD II i cili pas 30 vitesh në emigrim ka ardhur në Shqipëri për të investuar dhe fuqizuar zonën dhe produktet tradicionale të zonës së Shkodrës.

Në kemi pritshmëri të larta për mbrojtjen e produkteve të origjinës shqiptare dhe ndaj finalizuam dhe miratuam edhe të gjithë kuadrin ligjor, duke bërë efektive procedurën e marrjes së certifikimeve për produktet autoktone, ngritjen e Komisionit përkatës dhe dhënien e 3 certifikimeve të para produkte autoktone shqiptare - "Specialitet Tradicional i Garantuar" dhe 2 produkte në proces certifikimi si produkte me "Emërtim Orgjine të Mbrojtur".

UJITJE KULLIM- MBROJTJE NGA PËRMBYTJET

Kemi vijuar investimet publike dhe mirëmbajtja sistematike në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja të tokave bujqësore. Në vitin 2022, kemi investuar 1198 milion lekë, në 43 objekte, nga të cilat 28 kanë përfunduar dhe 15 janë në vazhdim dhe përfundojnë në vitin 2023.

Në ujitje kemi financuar 15 objekte me vlerë 204 milion lekë, nga të cilat 13 kanë përfunduar dhe 2 përfundojnë këtë vit. Kështu është mundësuar rehabilitimi pjesor i kanaleve kryesor ujitës, për përmirësimin e ujitjes në rreth 10,000 ha, duke garantuar furnizimin me ujë të kanaleve sekondar në bashkitë Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë dhe Vau i Dejës.

Ndërkohë, që nëpërmjet mirëmbajtjes së kanaleve kryesor ujitës në

BUJQËSIA NË VITIN 2023

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca: 2022-shi një vit nga më sfiduesit për bujqësinë. Mbështetëm mbi 49 mijë fermerë në uljen e kostove të prodhimit, duke ofruar buxhetin më të madh të vënë në dispozicion të subvencionit 9 masa financimi. Blegtoria prioritet i bujqësisë, rrisim mbështetjen për fermerët, agropërpunuesit, peshkatarët dhe gjithë komunitetin rural

(Vijon nga faqja 14)

administrim të MBZHR, është garantuar furnizimi me ujë në rreth 110 000 ha, kryesisht në zonat intensive bujqësore, në Shkodër, Lezhë, Rogozhinë, Peqin, Kavajë, Lushnje, Divjakë, Fier etj.

Në mbrojtje nga përmbytja kemi financuar 24 objekte, me vlerë 611 milion lekë, nga të cilët 13 kanë përfunduar, ndërsa 11 përfundojnë në vitin 2023.

Me këto investime është mundësuar rehabilitimi/ndërtimi i irreth 15 km argjinatura për mbrojtjen nga gërryerja dhe përmbytja të tokave bujqësore dhe zonave të banuara, më të ekspozuara nga rreziku i përmbytjeve lumore, kryesisht në lumin Buna në Bahçallëk, Dajç dhe Daragjat, në lumin Kir në fshatin Bardhaj, bashkia Shkodër, në lumin Osum në Uznovë, Arrëz dhe Gegë, bashkia Berat dhe Kuçovë, në lumin Vjosa në Bishan, Kafaraj dhe Selenicë bashkia Vlorë, Fier dhe Selenice, në lumin Shkumbin, në Muriqan dhe Elbasan, Bashkia

Kemi financuar 4 hidrovore, me vlerë 248 milion lekë, nga të cilët 2 kanë përfunduar, ndërsa 2 përfundojnë në vitin 2023.

Në 2 hidrovore Balldre në Lezhë dhe Drojë në Kurbin, kanë përfunduar punimet, që kanë të bëjnë me rikonstruksionin e godinave të këtyre hidrovoreve.

Ndërsa, punimet për rikonstruksionet e plota të hidrovorit të Karavastas, që kullon rreth 7000 ha dhe hidrovorit të Akërnisë në Vlorë, që kullon 4600 ha, përfundojnë gjatë vitit 2023.

Gjithashtu perveç këtyre investimeve me shpenzimet operative rreth 407 milion lekë është mundësuar:

- Mirëmbajtja/përmirësimi i kullimit në rreth 50 000 ha (si process ciklik i mirëmbajtjes vjetore), nëpërmjet lëvizjes së rreth 1.8 milion m3 dhera (në rreth 250 km kanale kryesore);

- Përmirësimi i ujitjes në rreth 25 000 ha dhe venia në funksion i veprave të marrjes së ujit për skemat kryesore të ujitjes;

- Janë kryer remontet vjetore të hidrovoreve si dhe mbajtja në funksionim të plotë të 27 hidrovoreve, sidomos gjatë periudhave me rreshje shiu.

Objektivat për 2023 - ZHVILLIMI RURAL

Në 2023, do të kemi mbështetje të lartë për zhvillimin rural..

Jemi zotuar dhe do të vijojmë të dedikojmë financim për:

- Rritjen e eksporteve, për produktet potenciale, nëpërmjet nxitjes së produktivitetit duke mbështetur dhe financuar rritjen e sipërfaqes së serrave, fuqizimin e fermave të mëdha, forcimin e agropërpunimit, rritjen e mekanizimit si dhe teknologjitë inovative;

- Rritje e produktivitetit nëpërmjet orientimit drejt kulturave të kërkuara nga tregjet ndërkombëtare me mekanizim, si dhe mbështetjen e drejtpërdrejt me naftë pa akcizë duke ndikuar në rritjen e sipërfaqes së prodhuar.

- Mbështetje për agropërpunuesit për fuqizimin e kapaciteteve dhe linjave përpunuese dhe përmirësimin e infrastrukturës duke i shtuar vlerë produktit primar në vend; Duam gjithashtu të vijojmë promovimin e produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim; IPARD #

Sot është data 13 Janar dhe ne kemi nisur punën për IPARD III, me paketën e akreditimit të masave të reja. Programi i ri do të mbështesë fermerët dhe sipërmarrësit përmes 9 masave të Programit, duke bërë që Shqipëria të vijojë të jetë lider në rajon për zbatimin e programit IPARD dhe për përthithjen e fondeve në mbështetje të bujqësisë.

Sfida për ne do të jetë të hapim thirrjen e parë të Programit IPARD III sa më shpejt dhe të finalizojmë akreditimin për 5 masat e reja. Kështu çdo fermer, blegtor, agropërpunues etj, do të mund të aplikojë në thirrjet e IPARD III, për të përfunduar një vlerë të grantit për investime nga 5,000 EUR në 1 milionë EUR, ku në varësi të masave të investimit financohen nga 50%, të investimit deri në 100% të investimit.

PROGRAM ZHVILLIMI RURAL ME GIZ dhe qeveria zvicerane me program për blegtorinë. - Ky program synon të sjellë investime në teknologji në sektorin agroushqimor apo zgjerimin e fermave ekonomiksht të qendrueshme dhe ka për objektiv punësimin e mbi 5000 personave.

Do të vazhdojmë punën për një kuadër ligjor dhe rregullator të plotë me Dokumentin për Zhvillimin Strategjik të Agroturizmit 2023-2027, me ndryshimet e VKM për procedurat e certifikimit të agroturizimeve, me objektivin për ta bërë më të aksesueshëm sektorin. Presim të miratojmë në Kuvend projektligjin për Bletarinë për miratim në Kuvend dhe projektligjin "Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish ndermarrjeve bujqësore".

Për vitin 2023 për infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit, do të financohen gjithsej 37 objekte të infrastrukturës së ujitjes, mbrojtjes nga përmbytja dhe hidrovore, nga të cilat 15 objekte janë në vazhdim nga viti 2022.

Në ujitje po synojmë të planifikojmë përmirësimin e ujitjes në rreth 12,000 ha, duke ndërrhyrë në rehabilitimin e disa kanaleve kryesore ujitës, siç janë kanalet Peqin-Kavajë, Mat-Lezhë, Shtodër, Bërdicë, si dhe përfundimi i rehabilitimit të kanalit ujitës të Gjançit dhe kanalit PolisTudan, duke garantuar furnizimin me ujë të kanaleve sekundare në administrim të bashkive Peqin, Rogozhinë, Kavajë, Shkodër, Malësi e Madhe, Lezhë, Korçë, Elbasan, etj.

Në mbrojtjen nga përmbytja për rehabilitimi/ndërtimin i rreth 22 km argjinatura për mbrojtjen nga gërryerja dhe përmbytja të tokave bujqësore dhe zonave të banuara, më të ekspozuara nga rreziku i përmbytjeve lumore, kryesisht në lumenjtë Buna, Vjosa, Osum, Shkumbin, Devoll, Erzen, Suhë, etj.

Do të përfundojmë rikonstruksionin e plotë i hidrovorit të Akërnisë për rritjen e sigurisë së kullimit në rreth 4600 ha tokë në fushën e Akërnisë, terror brenda të cilit përfshihet edhe ndërtimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.

Së fundmi, në vitin 2023, fillon zbatimi i projektit "Zhvillimi i Bujqësisë së qendrueshme ndaj ndryshimeve klimatike" që po negociojmë me Bankën Botërore ku do të mbështetet "Promovimi i zinxhirëve të vlerave të qendrueshëm dhe elastike ndaj klimës". Ky projekt do ta prekë zhvillimin rural në dy drejtime:

- Nënndërrhyrjet infrastrukturorë, pasi do të bëhet i mundur:

- Rehabilitimi i skemës ujitëse me burim ujor rezervuarin e Janjarit dhe Mursisë, (Faza e II)

- Ujitje me presion deri në nivelin e kanaleve sekundar, për rreth 2200 ha të fushës së Mursisë, Bashkia Konispol.

- Kompletimi i ujitjes me presion për një zonë pilot prej rreth 500 ha në skemën ujitëse të Divjakës

- Rikonstruksionin dhe modernizimin e 2 hidrovoreve të Hoxharës, në Fier: Këto dy hidrovore, së bashku kullojnë rreth 9600 ha të fushës së Hoxharës, ku ushtrjnë aktivitet bujqësor rreth 10,000 fermerë.

- Vleresimi i mundësive alternative të ujitjes së fushës së Tërbufit.

Në mbështetje të zhvillimit të zinxhirëve të shkurtër të vlerës, promovimi i produkteve tipike dhe autoktone. Me këtë komponent duam të rrisim aksesin në treg të produkteve vendase dhe do të mundësojmë ndërtimin e pesë objekteve që bëjnë të mundur klasifikim, seleksionim dhe paketim në zonat në periferi të qyteteve kryesore për menaxhimin aktiv të prodhimit nga prodhuesit lokalë dhe rajonalë.

5. DIXHITALIZIMI

Ky është një objektivi tjetër i rëndësishëm për ne - kantieri të rëndësishme të teknologjisë në sektorin e bujqësisë.

Objektivin në këtë proces e kemi qartazë të lidhur me përmirësimin në mënyrë rrënjësore të grumbullimit, ruatjes, qarkullimit dhe përditësimit të informacionit në nivel jo vetëm rajoni dhe qarku, por fermë, dhe fermeri.

Arritje e padiskutueshme është puna e bërë gjatë 2022 viti e që vijon përgjatë 2023 për Regjistrin e Fermës së certifikuar, një pasqyrë e plotë që tregon të gjithë inventarin bujqësor për secilën fermë dhe që na jep informacionin e saktë jo vetëm për tokën ku po prodhohet, por dhe për protokollin dhe pesticidet që po përdoren.

Regjistri Kombëtar i Blegtorisë, të verifikuar me informacion nga terreni, i cili mundëson gjurmim të saktë në çdo fazë të mbarështimit dhe shëndetit të kafshëve. Sistemi RUDA ka depërtuar dhe funksional në çdo thetore dhe ka ndihmuar në kursimin e kohës së hedhjes së të dhënave falë përdorimit të

2022	DIGITALIZIMI	2023
Regjistri i Fermës Regjistruar 6 përditësuar informacioni për të gjithë fermerët me NIFP - Përditësuar mbi 100 mijë ferma me kod unik	Sistemi Ruda Sistemi i regjistrimit të kafshëve të matrukuara dhe fermave blegtorale në çdo thetore - 390 mijë kafshë të regjistruara	Portali i Fermerit 65 çmime produkteve të letësuara nga 10 tregje
IPARD Zhvilluar Sistemi dhe integruar në E-Albania.	LIMS ISUV do të fillojë të printojë analizat e rezultateve përmes sistemit të ri, në fund të muajit janar	AKUNET Një rrjet të digitalizuar të sigurisë ushqimore në vend
	Land Information System Orientim i plotë i fermave bazuar në të dhënat e tokës	Land Information System Orientim i plotë i fermave bazuar në të dhënat e tokës
	Digitalizimi i tokave bujqësore 5680 ha të digitalizuar / 40% e tokës bujqësore të MBZHR	

tableteve, duke sjellë siguri në proces, rritje të gjurmueshmërisë dhe rritje të sigurisë ushqimore përmes regjistrimit në kohë reale të informacionit.

Po fuqizojmë sistemin LIMS të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, i cili ka një rol kyç në sigurinë ushqimore, që mundëson dixhitalizimin e të gjithë proceseve laboratorike dhe shkurtimin ndjeshëm të kohës së pritjes së analizave. Sot ky sistem është zhvilluar dhe implementuar, dhe kryhet gjenerimi i përgjigjeve elektronike për raportin e provës (përgjigjet e analizave), në 38 laboratorë të ISUV. Ky sistem që ndërvepron e-albania, është i ndërlidhur me sistemin RUDA.

Nga fundi i Janarit ky sistem do të jetë plotësisht funksional.

Shqipëria do të jetë i pari vend pjesëmarrës në programin IPARD, që do të kryejë digjitalizimin e të gjithë proceseve të aplikimit dhe kontrollit deri tek finalizimi i investimeve, duke përgjysmuar kohën e procesimit të çdo aplikimi duke siguruar transparencën maksimale të procesit. Ne llogarisim, që nga ky sistem të mundësojë kursimin e kohës për më shumë se 2 mijë aplikantë, dhe rritjen e numrit të aplikantëve si edhe kursim i kohës për marrjen e dokumentacioneve nga zyrat e shtetit ose nga E-Albania sepse dokumentacioni do të kalojë automatikisht përmes sistemit.

Puna tashmë ka filluar, por inensiteti do të jetë më i lartë në 2023, deri në finalizim për portalin e fermerit, për sistemin AKUNET, për Sistemin e Informacionit të Tokës Bujqësore, dhe për digjitalizimin e tyre.

Shumë shpejt, do të vemë në funksionim PORTALIN E FERMERIT, si një dritare unike të tij, që do të jetë dritarja e vetme e informacionit teknik, rreth financimeve për bujqësinë, laboratorëve të analizave, skemave të mbështatjes, veterinerit apo ekstensionistit që ndodhet më pranë fermës. Por mbi të gjitha ne do të krijojmë një dritare transparence në të cilën fermerët do të shohin të përditësuar çmimet e produkteve 27 bujqësore në tregjet e shumicës dhe pikave të grumbullimit të zonës së tyre. Ky projekt kaq i rëndësishëm, i kërkuar nga ana e fermerëve dhe një prej premtimeve tona, do të prezantohet më gjerësisht në një aktivitet të veçantë për fermerët dhe operatorët e bujqësisë, blegtorisë, dhe agropërpunimit.

Po vëmë në jetë një sistem për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, i cili do të gjurmtojë në kohë reale procedurat e inspektimit, duke menaxhuar me efektivitet dhe transparencë analizimin e planeve të riskut. Me këtë sistem mundësojmë, që t'i heqim nga dora inspektorit ushqimor mundësinë për të abuzuar me detyrën e tij. Do ta ndërlidhim këtë sistem me e- Albania, e-tax, sistemin e QKB-së, ASYCUDA, RUDA dhe LIMS, duke krijuar një rrjet të digitalizuar të sigurisë ushqimore në vend me informatizimin e të gjitha proceseve të punës në AKU dhe duke automatizuar procedurat e terrenit në pikat e kalimit kufitar, laboratorëve dhe prodhimin e raporteve dhe statistikave.

Për rritjen e efektivitetit të përdorimit të tokës bujqësore, po ngremë Web GIS për të dhënat e tokës – Land Information System - programin e menaxhimit të qendrueshëm të tokës bujqësore ku kemi ndërtuar një sistem me të dhënat kadastrale, të pronësisë, cilësisë dhe përdorimit të tokës.

Ky program do t'u mundësojë fermerëve akses online mbi cilësinë e tokës që zotërojnë dhe problemet që ka, investimet që duhet të kryhen për të patur efektivitet të lartë ekonomik, masat që duhen marrë për normalizimin e treguesve tokësorë, plehrat që duhen përdorur, si dhe sistemet e punimit, kullimit dhe mbrojtjes së tokës që duhen aplikuar. Kështu sjellim rritje të efektivitetit të inpueteve bujqësore, uljen e kostot së prodhimit si dhe minimizimin e ndotjes

së mjedisit dhe produkteve bujqësore dhe orientim në zgjedhjen e kulturave më të përshtatshme për tu mbjellë bazuar në tipin e tokës.

Ne kemi filluar me digjitalizimin e tokave bujqësore në Administrimin e MBZHR. Nga rreth mbi 7000 parcela dhe rreth 14000 ha që kishin mbetur disponibel për t'u dhënë me qera, janë hedhur në hartë rreth, 5580 ha të digitalizuara (4134 parcela) përbën 40% e tokës bujqësore në administrim të MBZHR.

Ne i ofrojmë online investitorëve potencialë një informacion të gjerë rreth tokës disponibel për tu dhënë me qera - vendodhjen gjeografike të parcelave, sipërfaqen e tyre, infrastrukturën rrugore, largësinë nga tregjet, infrastrukturën e kullimit, aksesin në burimet ujore, etj. I gjithë ky informacion do të jetë edhe pjesë e portalit të fermerëve.

6. PESHKIMI

Në fund dua të flas pak për Peshkimin- një sektor për ne tejet i rëndësishëm i cili në vitin e fundit u përball me sfida të ngjashme si e gjithë ekonomia. Rritja e çmimit të naftës si rezultat i luftës në Ukrainë e vendosi peshkimin shqiptar në një situatë tejet të vështirë duke reduktuar në muajt mars – qershor aktivitetin e peshkimit detar me gati 80% dhe ndikoi patjetër të gjithë zinxhirin e vlerës. Megjithatë eksporti i produkteve të peshkut të freskët dhe përpunimit të produkteve detare, arriti sipas parashikimeve paraprake në 16.4 miliardë lekë, me një rritje të lehtë me 6%.

Morëm masa për ta mbështetur sektorin sipas sinjalizimeve që patëm, menjëherë për periudhën korrik-dhjetor dhe i përfshimë anijet e peshkimit në një Skemë të posaçme të Mbështetjes me Naftën me 40 lekë për litër, nga e cila kanë përfutur 190 anije.

Por kjo nuk është ndihma e vetme e rëndësishme në sektor. Peshkimi gjatë vitit 2022 u mbështet me grante të cilat financuan 50% të investimeve në bordin e anijeve të peshkimit, në ndërrimin e motorëve, për efencencën energjetike, riparimin e anijeve, instalimin e frigoriferëve, pajisjeve elektronike, mjeteve të peshkimit etj. Së bashku me investimet 29 e kryera nga vetë anijet e peshkimit, investimet për anijet e peshkimit në vitin 2022 ishin rreth 700 milion lekë ose mesatarisht rreth 40 000€ për anije. Nga kjo mbështetje përfutuan 150 anije peshkimi.



Ofrojmë kështu siguri në bord, rrisim eficiencën dhe efektivitetin si dhe sigurinë ushqimore për konsumatorët.

Këtë vit përfundoi edhe markata e tregtimit të peshkut në Vlorë. Kjo markate i shtohet asaj në Shëngjin e cila i është dhënë Bashkisë Lezhë për zhvillim dhe vënien në punë.

Kemi ritur kapacitetet ankoruese në portin e peshkimit Durrësit duke rehabilituar 185 ml bankina për zëvendësimin e bankinave me gurë në bankine me palankola për ankorimin e anijeve. Kjo është faza e parë e ndërrhyrjes në këtë port.

Kemi ritur kuotat e zënies së tonit me +55% duke ndikuar në eksporte. Rritëm kapacitetet monitoruese të Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës në bashkëpunim me BE, përmes dy anijeve të reja patru luese moderne të pajisura me të gjitha aparaturat në bordin e tyre për një navigim të sigurt dhe për të garantuar kryerjen e detyrave dhe të misionit në det, sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

OBJEKTIVI 2023

Kemi për objektivi të rrisim eksportet në 145 milionë EUR, përmes aksesit në tregje të reja dhe zgjerim të tregjeve ekzistuese.

Do të maksimizojmë infrastrukturën e peshkimit përmes portit në Vlorë dhe portit në Sarandë, përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me operatorët privatë.

Po finalizojmë me Universitetin Bujqësor i Tiranës studimin për përcaktimin e zonave të brendshme të akuakulturës, që të avancojmë kështu në përdorimin e qendrueshëm edhe të ujërave të brendshme.

Do të ndërhyjmë në infrastrukturën e peshkimit edhe përmes një programi afatgjatë të rëndësishëm me kooperacionin italian në programin Ekonomia Blu prej 25 milionë euro për:

Shtim të kapacitetit ankorues në Portin e Durrësit, do të lehtësojmë procedurat e zbarimit të produkteve peshkore të anijeve të peshkimit. Gjatë viteve 2023 - 2025 do të zëvendësohen gurët edhe për rreth 600 ml të tjerë.

Në Durrës do të ndërtojmë Markatën në Portin e Peshkimit

Në Sarandë do të ndërtojmë Markata e Peshkimit

Në Vlorë investime për Bankinë dhe struktura ndihmëse

Do të ngrihen 7 pika ankorimi në të gjithë vendin me krijimin e tregjeve të reja për produktet peshkore, do të rrisin sasinë, cilësinë, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e këtyre produkteve duke i bërë ato më atraktive si në tregun e brendshëm ashtu dhe për tregjet ndërkombëtare.

Në fund

Përmbledhja mund të ketë qënë pak e gjatë, por nuk doja të lija pa përmendur punën e askujt, duke filluar nga ekipi ynë në Ministri dhe duke kaluar të veterinarit dhe agronomit në terren apo fermerët dhe peshkatarët kudo në Shqipëri. Çdo investim dhe çdo politikë e re është për ta, për të gjithë ne, për një siguri të prodhimit, të cilësisë së ushqimit që konsumojmë, të të ardhurave familjare dhe në rritje të mirëqënies.

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

